FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 181

Tiranë – E premte, 21 dhjetor 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 89/2018 datë 3.12.2018	Për një ndryshim në ligjin nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar	12299
Ligj nr. 90/2018 datë 3.12.2018	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lisbonës për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar	12299
Ligj nr. 91/2018 datë 3.12.2018	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Amendamentin e Kigalit të protokollit të Montrealit "Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit"	12305
Ligj nr. 100/2018 datë 13.12.2018	Për një ndryshim në ligjin nr. 7764, datë 2.11.1993, "Për investimet e huaja", të ndryshuar	12313
Ligj nr. 101/2018 datë 13.12.2018	Për disa shtesa në ligjin nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar	12314
Ligj nr. 102/2018 datë 13.12.2018	Për disa shtesa në ligjin nr. 55/2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë"	12314
Ligj nr. 103/2018 datë 13.12.2018	Për disa ndryshime në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar	12315
Ligj nr. 104/2018 datë 13.12.2018	Për një shtesë në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar	12316
Akt Normativ i Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 19.12.2018	Për disa ndryshime në ligjin nr.109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", të ndryshuar	12316

Njoftim i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme nr. 19082, datë 18.12.2018	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare.....	12325
Njoftim i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme nr. 19087, datë 18.12.2018	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje dypalëshe me Gjermaninë.....	12325

LIGJ
Nr. 89/2018

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 102/2015, "PËR SEKTORIN E GAZIT NATYROR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në pikën 5, të nenit 5, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, fjalia e fundit ndryshohet, si më poshtë:

"Për të ushtruar veprimtarinë studimore-projektuese, personat fizikë ose juridikë duhet të kenë të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt veprimtarie, kryerjen e kësaj veprimtarie dhe duhet të kenë të punësuar specialistë të pajisur me certifikatë profesionale.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 3.12.2018

Shpallur me dekretin nr. 11000, datë 18.12.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

LIGJ
Nr. 90/2018

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN E LISBONËS PËR MBROJTJEN E EMËRTIMEVE TË ORIGJINËS DHE REGJISTRIMIN E TYRE NDËRKOMBËTAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në marrëveshjen e Lisbonës për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 3.12.2018

Shpallur me dekretin nr. 11001, datë 18.12.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJA E LISBONËS
PËR MBROJTJEN E EMËRTIMEVE TË ORIGJINËS DHE REGJISTRIMIN E TYRE NDËRKOMBËTAR, E DATËS 31 TETOR 1958, E RISHIKUAR NË STOKHOLM NË DATËN 14 KORRIK 1967 DHE E NDRYSHUAR NË DATËN 28 SHTATOR 1979

Neni 1
Themelimi i një Unioni të Posaçëm; mbrojtja e emërtimeve të origjinës të regjistruara në Byronë Ndërkombëtare[1]

1. Vendet ku zbatohet kjo Marrëveshje formojnë një Union të Posaçëm në kuadër të Unionit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale.

2. Ata marrin përsipër të mbrojnë brenda territoreve të tyre, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, emërtimet e origjinës së produkteve të vendeve të tjera të Unionit të Posaçëm, të njohura dhe të mbrojtura si të tilla në vendin e origjinës dhe të regjistruara në Byronë Ndërkombëtare të Pronësisë Intelektuale (në vijim e referuar si "Byroja Ndërkombëtare"

[1] Neneve u janë vendosur tituj për të lehtësuar identifikimin e tyre. Nuk ka tituj në tekstin e nënshkruar në frëngjisht. Titulli i nenit 6 është ndryshuar, në krahasim me botimin e mëparshëm.

ose "Byroja"), e përmendur në Konventën për themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (në vijim e referuar si "Organizata").

Neni 2
Përkufizimi i nocioneve të emërtimit të origjinës dhe vendit të origjinës

1. Në këtë Marrëveshje "emërtimi i origjinës" nënkupton emërtimin gjeografik të një vendi, rajoni ose lokaliteti, i cili shërben për të përcaktuar një produkt me origjinë nga këto vende, cilësia ose karakteristikat e të cilave u atribuohen ekskluzivisht ose kryesisht mjedisit gjeografik, duke përfshirë faktorët natyrorë dhe njerëzorë.

2. Vendi i origjinës është vendi emri i të cilit ose vendi ku ndodhet rajoni ose lokaliteti emri i të cilit përbën emërtimin e origjinës që i ka dhënë produktit reputacionin e tij.

Neni 3
Përmbajtja e mbrojtjes

Mbrojtja sigurohet kundrejt çdo zaptimi ose imitimi, edhe nëse është përcaktuar origjina e vërtetë e produktit ose nëse emërtimi përdoret me emrin e përkthyer ose shoqërohet me terma të tillë, si: "lloji", "tipi", "prodhimi", "imitimi" ose të tjera të ngjashme.

Neni 4
Mbrojtja në bazë të teksteve të tjera

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk përjashtojnë në asnjë mënyrë mbrojtjen e dhënë për emërtimet e origjinës në secilin nga vendet e Unionit të Posaçëm, në bazë të instrumenteve të tjera ndërkombëtare, si Konventa e Parisit, e datës 20 mars 1883 për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe rishikimet e saj të mëvonshme, dhe Marrëveshja e Madridit, e datës 14 prill 1891, për Shmangien e Treguesve të Rremë ose Mashtrues të Burimit të Mallrave dhe rishikimet e mëvonshme, në bazë të legjislacionit kombëtar të brendshëm ose vendimeve të gjykatës.

Neni 5
Regjistrimi ndërkombëtar; refuzimi; njoftimet; përdorimi i toleruar për një periudhë të caktuar

1. Regjistrimi i emërtimeve të origjinës kryhet në Byronë Ndërkombëtare, me kërkesë të autoriteteve të vendeve të Unionit të Posaçëm, në emër të çdo personi fizik apo juridik, publik ose privat, të cilët, sipas legjislacionit të tyre kombëtar, gëzojnë të drejtën e përdorimit të këtyre emërtimeve.

2. Byroja Ndërkombëtare njofton pa vonesë autoritetet e vendeve të ndryshme të Unionit të Posaçëm për këto regjistrime dhe i boton në një botim periodik.

3. Autoriteti i çdo vendi mund të deklarojë se nuk mund të sigurojë mbrojtjen e emërtimit të origjinës për të cilin autoriteti është njoftuar, por vetëm për sa kohë që kjo deklaratë i është njoftuar Byrosë Ndërkombëtare, së bashku me treguesit e arsyeve, brenda një periudhe njëvjeçare nga marrja e njoftimit për regjistrim dhe me kusht që kjo deklaratë të mos jetë e dëmshme në vendin përkatës, për format e tjera të mbrojtjes së emërtimit, zotëruesi i të cilit mund të gëzojë të drejtën të pretendojë sipas nenit 4 më sipër.

4. Kjo deklaratë mund të mos kundërshtohet nga autoritetet e vendeve të Unionit pas përfundimit të periudhës njëvjeçare të parashikuar në paragrafin e mësipërm.

5. Byroja Ndërkombëtare duhet të njoftojë autoritetin e vendit të origjinës, sa më shpejt të jetë e mundur, .për çdo deklaratë të bërë nga autoriteti i një vendi tjetër, sipas kushteve të paragrafit 3. Pala e interesuar, kur informohet nga autoriteti i tij kombëtar për deklaratën e bërë nga një vend tjetër, mund të përdorë në atë vend tjetër të gjitha zgjidhjet ligjore dhe administrative të hapura për shtetasit e atij vendi.

6. Nëse ky emërtim që është pajisur me mbrojtje në një vend të caktuar sipas njoftimit për regjistrimin e tij ndërkombëtar, është përdorur më parë nga palët e treta në atë vend nga një datë përpara këtij njoftimi, autoriteti kompetent i atij vendi gëzon të drejtën të japë për palët e treta një periudhë që nuk i kalon dy vjet për ndërprerjen e këtij përdorimi, me kusht që të kështillojë siç duhet Byronë Ndërkombëtare gjatë tre muajve pas skadimit të periudhës njëvjeçare të parashikuar në paragrafin 3 më sipër.

Neni 6
Mbrojtja kundër transformimit të përgjithshëm

Emërtimi i pajisur me mbrojtje në një nga vendet e Unionit të Posaçëm në përputhje me procedurën sipas nenit 5 nuk mund të konsiderohet i përgjithshëm në atë vend, për sa kohë që është i mbrojtur si emërtim i origjinës në vendin e origjinës.

Neni 7
Periudha e vlefshmërisë së regjistrimit; tarifa

1. Regjistrimi i kryer në Byronë Ndërkombëtare në përputhje me nenin 5 siguron, pa të drejtë rinovimi, mbrojtjen për të gjithë periudhën e përmendur në nenin e mësipërm.

2. Do të paguhet një tarifë e vetme për regjistrimin e çdo emërtimi të origjinës.

Neni 8
Procedimet ligjore

Veprimet ligjore të nevojshme për të siguruar mbrojtjen e emërtimeve të origjinës mund të merren në secilin vend të Unionit të Posaçëm sipas dispozitave të legjislacionit kombëtar:

1. Me kërkesë të autoritetit kompetent ose me kërkesë të prokurorit publik;

2. Nga çdo palë e interesuar, qoftë person fizik ose person juridik, publik apo privat.

Neni 9
Asambleja e Unionit të Posaçëm

1. a) Unioni i Posaçëm ka një Asamble të përbërë nga ato vende që e kanë ratifikuar ose aderuar në këtë marrëveshje.

b) Qeveria e secilit vend përfaqësohet nga një përfaqësues, i cili mund të asistohet nga përfaqësues, këshilltarë dhe ekspertë të ndryshëm.

c) Shpenzimet e secilit delegacion mbulohen nga Qeveria që e ka caktuar atë.

2. a) Asambleja:

i. trajton të gjitha çështjet që lidhen me ruajtjen dhe zhvillimin e Unionit të Posaçëm dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;

ii. i jep Byrosë Ndërkombëtare udhëzime në lidhje me përgatitjen e konferencave të rishikimit, duke marrë parasysh edhe çdo koment të bërë nga ato vende të Unionit të Posaçëm që nuk kanë ratifikuar apo aderuar në këtë akt;

iii. ndryshon rregulloret, duke përfshirë përcaktimin e shumës së tarifës së përmendur në nenin 7, paragrafi 2 dhe tarifat e tjera që lidhen me regjistrimin ndërkombëtar;

iv. shqyrton dhe miraton raportet dhe veprimtaritë e Drejtorit të Përgjithshëm të Organizatës (në vijim i referuar si "Drejtori i Përgjithshëm") në lidhje me Unionin e Posaçëm dhe i jep atij të gjitha udhëzimet e nevojshme për çështjet që mbulohen nga Unioni i Posaçëm;

v. përcakton programin dhe miraton buxhetin dyvjeçar të Unionit të Posaçëm dhe miraton llogaritë e tij përfundimtare;

vi. miraton rregulloret financiare të Unionit të Posaçëm;

vii. krijon komitete ekspertësh dhe grupe pune, siç mund ta çmojë të nevojshme për të përmbushur objektivat e Unionit të Posaçëm;

viii. përcakton cilat vende që nuk janë anëtare të Unionit të Posaçëm dhe cilat organizata ndërqeveritare dhe ndërkombëtare joqeveritare do të pranohen në takimet e tyre në rolin e vëzhguesit;

ix. miraton ndryshimet në nenet 9 deri 12;

x. ndërmerr çdo masë tjetër të përshtatshme që synon të zhvillojë më tej objektivat e Unionit të Posaçëm;

xi. kryen funksione të tjera të përshtatshme sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Në lidhje me çështjet me interes edhe për Unionet e tjera nën administrimin e Organizatës, Asambleja merr vendimet e saj pasi të ketë dëgjuar informacionin e Komitetit Koordinues të Organizatës.

3. a) Çdo anëtar i vendit të Asamblesë gëzon një votë.

b) Gjysma e vendeve anëtare të Asamblesë përbën një kuorum.

c) Pavarësisht nga dispozitat e nënparagrafit "b", nëse në ndonjë seancë numri i vendeve të përfaqësuara është më pak se gjysma, por i barabartë ose më i madh se një e treta e vendeve anëtare të Asamblesë, Asambleja mund të marrë vendime por, me përjashtim të vendimeve që lidhen me procedurën e vet, të gjitha vendimet e tjera hyjnë në fuqi vetëm nëse plotësohen kushtet e përcaktuara më poshtë. Byroja Ndërkombëtare ua komunikon vendimet në fjalë vendeve anëtare të Asamblesë që nuk janë të përfaqësuara dhe i fton të hedhin me shkrim

votën e tyre ose të abstenojnë brenda një periudhe prej tre muajsh nga data e komunikimit. Nëse, pas skadimit të kësaj periudhe, numri i vendeve që kanë hedhur votën ose kanë abstenuar në këtë mënyrë arrin numrin e shteteve që mungonin për arritjen e kuorumit në seancë, këto vendime hyjnë në fuqi, me kusht që në të njëjtën kohë të fitohet shumica e nevojshme.

d) Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 2, vendimet e Asamblesë kërkojnë dy të tretat e votave të hedhura.

e) Abstenimet nuk konsiderohen si vota.

f) Një delegat mund të përfaqësojë dhe votojë vetëm në emër të një vendi.

g) Vendet e Unionit të Posaçëm që nuk janë anëtarë të Asamblesë pranohen në mbledhjet e kësaj të fundit si vëzhgues.

4) a) Asambleja mblidhet një herë çdo dy vite kalendarike në seancë të zakonshme pas thirrjes nga Drejtori i Përgjithshëm dhe, në mungesë të rrethanave të jashtëzakonshme, gjatë së njëjtës periudhë dhe në të njëjtin vend si Asambleja e Përgjithshme e Organizatës.

b) Asambleja mblidhet në seancë të jashtëzakonshme pas thirrjes nga Drejtori i Përgjithshëm, me kërkesën e një të katërtës së vendeve anëtare të Asamblesë.

c) Rendi i ditës i çdo seance përgatitet nga Drejtori i Përgjithshëm.

5. Asambleja miraton vetë rregulloren e saj të brendshme.

Neni 10
Byroja Ndërkombëtare

1. a) Regjistrimi ndërkombëtar dhe detyrat përkatëse, si dhe të gjitha detyrat e tjera administrative në lidhje me Unionin e Posaçëm, kryhen nga Byroja Ndërkombëtare.

b) Në veçanti, Byroja Ndërkombëtare përgatit mbledhjet dhe siguron sekretariatin e Asamblesë dhe të komiteteve të ekspertëve dhe grupeve të punës, siç është përcaktuar nga Asambleja.

c) Drejtori i Përgjithshëm është drejtuesi ekzekutiv i Unionit të Posaçëm dhe përfaqëson Unionin e Posaçëm.

2. Drejtori i Përgjithshëm dhe çdo anëtar tjetër i stafit të caktuar prej tij merr pjesë, pa të drejtë vote, në të gjitha mbledhjet e Asamblesë dhe të komiteteve të ekspertëve ose grupeve të punës që mund të jenë caktuar nga Asambleja. Drejtori i Përgjithshëm ose një anëtar tjetër i stafit të caktuar prej tij, është sekretar *ex officio* i këtyre organeve.

3. a) Byroja Ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimet e Asamblesë, kryen përgatitjet për konferencat për rishikimin e dispozitave të Marrëveshjes, përveç dispozitave të neneve 9 deri në 12.

b) Byroja Ndërkombëtare mund të konsultohet me organizatat ndërqeveritare dhe ndërkombëtare joqeveritare në lidhje me përgatitjet për konferencat e rishikimit.

c) Drejtori i Përgjithshëm dhe personat e caktuar prej tij marrin pjesë, pa të drejtë vote, në diskutimet e zhvilluara në këto konferenca.

4. Byroja Ndërkombëtare kryen çdo detyrë tjetër që i është caktuar.

Neni 11
Financat

1. a) Unioni i Posaçëm ka një buxhet.

b) Buxheti i Unionit të Posaçëm përfshin të ardhurat dhe shpenzimet e veçanta që i takojnë Unionit të Posaçëm, kontributin e tij në buxhetin e shpenzimeve të përbashkëta për Unionet dhe, sipas rastit, shumën e vënë në dispozicion të buxhetit të Konferencës së Organizatës.

c) Shpenzimet që nuk i atribuohen ekskluzivisht Unionit të Posaçëm, por gjithashtu një apo më shumë Unioneve të tjera të administruara nga Organizata, konsiderohen si shpenzime të përbashkëta për Unionet. Pjesa e këtyre shpenzimeve të përbashkëta që i takon Unionit të Posaçëm është në raport me interesin e Unionit të Posaçëm në to.

2. Buxheti i Unionit të Posaçëm krijohet duke pasur parasysh kërkesat e koordinimit me buxhetet e Unioneve të tjera të administruara nga Organizata.

3. Buxheti i Unionit të Posaçëm financohet nga burimet e mëposhtme:

i. taksat ndërkombëtare të regjistrimit të mbledhura sipas nenit 7, paragrafi 2 dhe tarifat dhe detyrimet e tjera për shërbime të kryera nga Byroja Ndërkombëtare në lidhje me Unionin e Posaçëm;

ii. të ardhurat nga shitja e ose honorarët nga botimet e Byrosë Ndërkombëtare në lidhje me Unionin e Posaçëm;

iii. dhuratat, trashëgimia dhe subvencionet;

iv. qiratë, interesat dhe të ardhura të tjera të ndryshme;

v. kontributet e vendeve të Unionit të Posaçëm, nëse dhe deri në masën kur faturat nga burimet e shënuara në pikat "i" deri në "iv" nuk mjaftojnë për të mbuluar shpenzimet e Unionit të Posaçëm.

4. a) Shuma e tarifës së përmendur në nenin 7, paragrafi 2, caktohet nga Asambleja me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.

b) Shuma e kësaj tarife në fjalë duhet të jetë fikse, në mënyrë që të ardhurat e Unionit të Posaçëm, në rrethana normale të jenë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e Byrosë Ndërkombëtare për mbajtjen e shërbimit të regjistrimit ndërkombëtar, pa pasur nevojë për pagesën e kontributeve në paragrafin 3, germa "v" më sipër.

5. a) Për qëllimin e caktimit të kontributit të përmendur në paragrafin 3, germa "v", secili vend i Unionit të Posaçëm i përket të njëjtës klasë që i përket në Unionin e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe paguan kontributet e tij vjetore në bazë të njësive të caktuara për atë klasë në atë Union.

b) Kontributi vjetor i secilit vend të Unionit të Posaçëm është shuma në raport të barabartë me shumën totale që duhet të paguhet në buxhetin vjetor të Unionit të Posaçëm nga të gjitha vendet, sa numri i njësive të klasës që i përket totalit të njësive të të gjitha vendeve kontribuuese.

c) Data e pagesës së kontributit caktohet nga Asambleja.

d) Vendi që nuk paguan kontributin e tij nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij të votës në asnjë organ të Unionit të Posaçëm, nëse shuma e detyrimit të tij është e barabartë ose më e madhe se shuma e kontributeve që i detyrohen atij për dy vitet e plota të mëparshme. Megjithatë, ky vend mund të lejohet të vazhdojë të ushtrojë të drejtën e tij të votës në atë organ nëse, dhe për sa kohë që ky i fundit bindet që vonesa e pagesës ka ndodhur për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme dhe të pashmangshme.

e) Nëse buxheti nuk miratohet para fillimit të një periudhe të re financiare, ai duhet të jetë në të njëjtin nivel me buxhetin e vitit paraprak, siç parashikohet në rregulloret financiare.

6. Në bazë të dispozitave të paragrafit 4, germa "a", duhet të vendoset shuma e tarifave dhe detyrimeve për shërbimet e kryera nga Byroja Ndërkombëtare në lidhje me Unionin e Posaçëm dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i raportojë Asamblesë këto shuma.

7. a) Unioni i Posaçëm ka një fond të kapitalit qarkullues, i cili përbëhet nga një pagesë e vetme e kryer nga çdo vend i Unionit të Posaçëm. Nëse ky fond bëhet i pamjaftueshëm, Asambleja vendos ta rrisë atë.

b) Shuma e pagesës fillestare të secilit vend në fondin në fjalë ose pjesëmarrja e tij në rritjen e këtij fondi është pjesë e kontributit të atij vendi, si anëtar i Unionit të Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale në buxhetin e Unionit në fjalë për vitin kur është krijuar ky fond ose kur është marrë vendimi për rritjen e tij.

c) Pjesa dhe kushtet e pagesës përcaktohen nga Asambleja me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe pasi të ketë dëgjuar informacionet e Komitetit Koordinues të Organizatës.

8. a) Në marrëveshjen për selinë të nënshkruar me vendin në territorin e të cilit Organizata ka selinë, duhet të parashikohet që sa herë që fondi i kapitalit qarkullues të jetë i pamjaftueshëm, ky vend duhet të paguajë pagesa paraprake. Shuma e këtyre pagesave paraprake dhe kushtet e pagesës i nënshtrohen marrëveshjeve të veçanta, në çdo rast midis këtij vendi dhe Organizatës.

b) Vendi i përmendur në nënparagrafin "a" dhe Organizata kanë të drejtë të prishin detyrimin për dhënien e pagesave paraprake, nëpërmjet një njoftimi me shkrim. Prishja e Marrëveshjes hyn në fuqi tre vjet pas përfundimit të vitit kur është njoftuar.

9. Auditimi i llogarive kryhet nga një ose më shumë vende të Unionit të Posaçëm ose nga audituesë të jashtëm, siç parashikohet në rregulloret financiare. Ato përcaktohen nga Asambleja me miratimin e tyre.

Neni 12

Ndryshimi i neneve 9 deri 12

1. Propozimet për ndryshimin e neneve 9, 10, 11 dhe të këtij neni mund të iniciohen nga çdo vend anëtar i Asamblesë ose nga Drejtori i Përgjithshëm. Drejtori i Përgjithshëm u komunikon këto propozime shteteve anëtare të

Asamblesë të paktën gjashtë muaj përpara shqyrtimit të tyre nga Asambleja.

2. Ndryshimet në nenet e përmendura në paragrafin 1 miratohen nga Asambleja. Ky miratim kërkon tre të katërtat e votave të hedhura, me kusht që çdo ndryshim i nenit 9 dhe i këtij paragrafi të kërkojë katër të pestat e votave të hedhura.

3. Çdo ndryshim i neneve të përmendura në paragrafin 1 hyn në fuqi një muaj pasi njoftimet me shkrim të pranimit, të miratuara në përputhje me proceset e tyre përkatëse kushtetuese, të jenë pranuar nga Drejtori i Përgjithshëm nga tre të katërtat e vendeve anëtare të Asamblesë në momentin e miratimit të këtij ndryshimi. Çdo ndryshim i këtyre neneve të pranuara në këtë mënyrë i detyron të gjitha vendet anëtare të Asamblesë në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimit ose vendet që anëtarësohen pas kësaj date, me kusht që çdo ndryshim që rrit detyrimet financiare të vendeve të Unionit të Posaçëm të jetë detyrues vetëm për ato vende që kanë njoftuar pranimin e këtyre ndryshimeve.

Neni 13
Rregulloret; rishikimi

1. Të dhëna për nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje janë të përcaktuara në rregullore.

2. Kjo marrëveshje mund të rishikohet nga konferencat e zhvilluara ndërmjet përfaqësuesve të vendeve të Unionit të Posaçëm.

Neni 14
Ratifikimi dhe aderimi; hyrja në fuqi; referenca në nenin 24 të Konventës së Parisit (territoret); aderimi në aktin e vitit 1958

1. Çdo vend i Unionit të Posaçëm që ka nënshkruar këtë Akt mund ta ratifikojë atë, dhe nëse nuk e ka nënshkruar, mund të aderojë në të.

2. a) Çdo vend jashtë Unionit të Posaçëm, i cili është palë në Konventën e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale, mund të aderojë në këtë Marrëveshje dhe në këtë mënyrë të bëhet anëtar i Unionit të Posaçëm.

b) Njoftimi i anëtarësimit, në vetvete, siguron në territorin e vendit pranues përfitimet e dispozitave të mësipërme për emërtimet e origjinës të cilat, në kohën e aderimit, janë subjekt i regjistrimit ndërkombëtar.

c) Megjithatë, çdo shtet që aderon në këtë marrëveshje, brenda një periudhe njëvjeçare mund të deklarojë në lidhje me emërtimet e origjinës të cilat, të regjistruara më parë në Byrosë Ndërkombëtare, dëshirën për të ushtruar të drejtën e parashikuar në nenin 5, paragrafi 3.

3. Instrumentet e ratifikimit dhe aderimit depozitohen pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

4. Në këtë Marrëveshje zbatohen dispozitat e nenit 24 të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale.

5. a) Në lidhje me pesë vendet e para që kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose aderimit, ky Akt hyn në fuqi tre muaj pas depozitimit të këtij instrumenti të pestë.

b) Për sa i përket çdo vendi tjetër, ky Akt hyn në fuqi tre muaj pas datës kur ratifikimi ose aderimi njoftohet nga Drejtori i Përgjithshëm, përveç nëse në instrumentin e ratifikimit ose aderimit shënohet ndonjë datë e mëvonshme. Në rastin e fundit, ky Akt hyn në fuqi vetëm për atë vend në datën e shënuar për këtë qëllim.

6. Ratifikimi ose aderimi sjell automatikisht pranimin e të gjitha klauzolave dhe pranimin e të gjitha avantazheve të këtij Akti.

7. Pas hyrjes në fuqi të këtij Akti, një vend mund të aderojë në Aktin origjinal të 31 tetorit 1958, të kësaj Marrëveshjeje, vetëm në lidhje me ratifikimin ose aderimin në këtë Akt.

Neni 15
Kohëzgjatja e Marrëveshjes; prishja e Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi për aq kohë që të jenë të paktën pesë vende palë në të.

2. Çdo vend mund ta prishë këtë Akt me anë të një njoftimi drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm. Prishja e kësaj Marrëveshjeje përbën edhe prishjen e Marrëveshjes për Aktin e 31 tetorit 1958, të kësaj Marrëveshjeje, dhe prek vetëm vendin që prish marrëveshjen, dhe Marrëveshja mbetet në fuqi të plotë për vendet e tjera të Unionit të Posaçëm.

3. Prishja e Marrëveshjes hyn në fuqi një vit pas ditës kur Drejtori i Përgjithshëm merr njoftimin.

4. E drejta e prishjes së marrëveshjes e parashikuar në këtë nen nuk ushtrohet nga asnjë vend përpara përfundimit të afatit pesëvjeçar nga data kur ky vend bëhet anëtar i Unionit të Posaçëm.

Neni 16
Aktet e zbatueshme

1. a) Ky Akt zëvendëson aktin origjinal të 31 tetorit 1958, në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet vendeve të Unionit të Posaçëm me të cilin është ratifikuar apo aderuar.

b) Megjithatë, çdo vend i Unionit të Posaçëm që ka ratifikuar ose ka aderuar në këtë Akt, është i detyruar nga Akti origjinal i 31 tetorit 1958, në lidhje me marrëdhëniet e tij me vendet e Unionit të Posaçëm që nuk kanë ratifikuar apo aderuar në këtë ligj.

2. Vendet jashtë Unionit të Posaçëm që bëhen palë në këtë Akt, e aplikojnë atë në regjistrimet ndërkombëtare të emërtimeve të origjinës të kryera në Byronë Ndërkombëtare, me kërkesë të Autoritetit të çdo vendi të Unionit të Posaçëm që nuk është palë në këtë Akt, me kusht që këto regjistrime të plotësojnë, në lidhje me vendet në falë, kërkesat e këtij Akti. Në lidhje me regjistrimet ndërkombëtare të kryera në Byronë Ndërkombëtare me kërkesë të Autoriteteve të vendeve në fjalë jashtë Unionit të Posaçëm të cilët bëhen palë në këtë Akt, këto shtete pranojnë që vendet e mësipërme të Unionit të Posaçëm mund të kërkojnë respektimin e kërkesave të Aktit origjinal të 31 tetorit 1958.

Neni 17
Nënshkrimi, gjuhët, funksionet e Depozitarit

1. a) Ky Akt nënshkruhet në një kopje të vetme në gjuhën frënge dhe depozitohet në qeverinë e Suedisë.

b) Tekstet zyrtare përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm, pas konsultimit me qeveritë e interesuara, në gjuhë të tjera siç përcaktohen nga Asambleja.

2. Ky Akt mbetet i hapur për nënshkrim në Stokholm deri në datën 13 janar 1968.

3. Drejtori i Përgjithshëm përcjell dy kopje të tekstit të nënshkruar të këtij Akti, të certifikuara nga Qeveria e Suedisë, Qeverive të të gjitha vendeve të Unionit të Posaçëm dhe me kërkesë të tyre, Qeverisë së çdo vendi tjetër.

4. Drejtori i Përgjithshëm e regjistron këtë Akt në Sekretariatin e Kombeve të Bashkuara.

5. Drejtori i Përgjithshëm njofton qeveritë e të gjitha vendeve të Unionit të Posaçëm për nënshkrimet, depozitimet e instrumenteve të ratifikimit ose aderimit, hyrjen në fuqi të çdo dispozite të këtij akti, prishjet e marrëveshjeve dhe deklaratat në përputhje me nenin 14, paragrafi 2, germa "c" dhe paragrafin 4.

Neni 18
Dispozita kalimtare

1. Derisa Drejtori i parë i Përgjithshëm të marrë detyrën, referencat në këtë Marrëveshje për Byronë Ndërkombëtare të Organizatës ose për Drejtorin e Përgjithshëm do të interpretohen si referenca në Byronë e Unionit të krijuar përkatësisht sipas Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale ose nga Drejtori i saj.

2. Vendet e Unionit të Posaçëm që nuk kanë ratifikuar apo aderuar në këtë Akt mund të ushtrojnë, deri në pesë vjet pas hyrjes në fuqi të Konventës për themelimin e organizatës, të drejtat e parashikuara nga nenet 9 deri në 12 të këtij Akti, njëlloj sikur të ishin të detyruar nga këto nene. Çdo vend që dëshiron të ushtrojë këto të drejta, i dërgon një njoftim me shkrim Drejtorit të Përgjithshëm. Ky njoftim hyn në fuqi nga data e pranimit të tij. Këto vende konsiderohen si anëtarë të Asamblesë deri në skadimin e afatit të lartpërmendur.

LIGJ
Nr. 91/2018

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË AMENDAMENTIN E KIGALIT TË PROTOKOLLIT TË MONTREALIT "PËR SUBSTANCAT QË HOLLOJNË SHTRESËN E OZONIT"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në amendamentin e Kigalit të Protokollit të Montrealit, "Për substancat që hollojnë shtresën

e ozonit", bërë më 15 tetor 2016, në Kigali, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 3.12.2018

Shpallur me dekretin nr. 11002, datë 18.12.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

KOMBET E BASHKUARA
Adresa: UNITED NATIONS, N.Y. 10017
Adresa kabllore UNATIONS NEWYORK

Lënda: C.N.872.2016. TREATIES-XXVII.2.F (njoftim i Depozitarit)

PROTOKOLLI I MONTREALIT PËR SUBSTANCAT QË HOLLOJNË SHTRESËN E OZONIT
I DATËS 16 SHTATOR 1987

AMENDAMENTI I PROTOKOLLIT TË MONTREALIT PËR SUBSTANCAT QË HOLLOJNË SHTRESËN E OZONIT, KIGALI, 15 TETOR 2016

MIRATIMI I AMENDAMENTIT

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, në cilësinë e Depozitarit, komunikon si vijon:

Palët në Takimin e Njëzetetetë të Protokollit të lartpërmendur, i mbajtur në Kigali nga datat 10 deri më 15 tetor 2016, kanë miratuar në pajtim me procedurën e parashikuar në paragrafin 4, të nenit 9, të Konventës së Vjenës për Mbrojtjen e Shtesës së Ozonit, një Amendament shtesë të Protokollit të Montrealit, siç është parashikuar në aneksin I të raportit të Takimit të Njëzetetetë të Palëve (vendim XXVIII/1).

Në përputhje me paragrafin 1, të nenit IV. Amendamenti do të hyjë në fuqi më 1 janar 2019, me kusht që të jenë depozituar nga ana e shteteve ose nga organizatat rajonale të integrimit ekonomik Palë të Protokollit të Montrealit për Substancat që Hollojnë Shtresën e Ozonit, të paktën Njëzet e tetë instrumente ratifikimi, aderimi apo miratimi të Amendamentit. Në rast se deri në atë datë ky kusht nuk është plotësuar, Amendamenti do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë, pas datës në të cilën ky kusht është përmbushur.

Në përputhje me paragrafin 4, të nenit IV, në vijim të hyrjes në fuqi të Amendamentit, ai do të hyjë në fuqi për çdo Palë tjetër të Protokollit në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, të aderimit ose miratimit.

Vëmendje: Drejtuar Shërbimeve të Marrëveshjeve dhe Traktateve të Ministrive të Punëve të Jashtme, si dhe organizatave ndërkombëtare të interesuara.

Njoftimet depozituese lëshohen vetëm në format elektronik. Njoftimet depozituese janë në dispozicion të Misioneve të Përhershme të Kombeve të Bashkuara në adresën: https://treaties.un.org., seksioni i përmbledhjes së Traktateve të Kombeve të Bashkuara "Njoftimet Depozituese". Përveç kësaj Misionet e Përhershme, si dhe çdo individ i interesuar, mund të abonohet në seksionin e traktateve. Shërbimet automatike të abonimit për të marrë njoftimet depozituese me e-mail ose në adresën https:treaties.un.org/Pages/Login.aspx?lang-en

C.N.872.2016.TRAKTATE-XXVII.2.f

ANEKSE

VENDIM: XXVIII/1: Amendament i Mëtejshëm i Protokollit të Montrealit

Për Miratimin e Amendamentit të Protokollit të Montrealit, i përcaktuar në shtojcën I të raportit të Takimit të Njëzetetetë të Palëve, në përputhje me procedurën e përcaktuar në paragrafin 4, të nenit 9, të Konventës së Vjenës, "Për mbrojtjen e shtresës së ozonit".

AMENDAMENT I PROTOKOLLIT TË MONTREALIT PËR SUBSTANCAT QË HOLLOJNË SHTRESËN E OZONIT

Neni I: Amendamenti

Neni 1, paragrafi 4

Në paragrafin 4, të nenit 1, të Protokollit, fjalët:

"Aneksi C ose aneksi E"

ndryshohen si më poshtë:

"Aneksi C, aneksi E ose aneksi F"

Neni 2, paragrafi 5

Në paragrafin 5, të nenit 2, të Protokollit, fjalët:

"dhe nenin 2H"

ndryshohen si më poshtë:

"Nenin 2H dhe 2J"

Neni 2, paragrafët 8 (a), 9 (a) dhe 11

Në paragrafin 8(a) dhe 11, të nenit 2, të Protokollit, fjalët:

"Neneve 2A deri në 2I"

Ndryshohen si më poshtë:

"Neneve 2A deri në 2J"

Fjalët e mëposhtme do të shtohen në fund të nënparagrafit "a", të paragrafit 8, të nenit 2, të Protokollit:

Çdo marrëveshje e tillë mund të shtrihet, duke përfshirë detyrimet në lidhje me konsumin ose prodhimin sipas nenit 2J, me kusht që niveli total i kombinuar i konsumit ose prodhimit të palëve të interesuara të mos kalojë nivelet e kërkuara nga neni 2J.

Në nënparagrafin "a" (i), të paragrafit 9, të nenit 2, të Protokollit, pas përdorimit të dytë të fjalëve:

duhet të bëhen,

fshihet fjala:

"dhe"

Nënparagrafi "a" (ii), i paragrafit 9, të nenit 2, të Protokollit, rinumërtohet si nënparagrafi "a" (iii).

Përmbajtja e mëposhtme shtohet si nënparagraf "a" (ii) pas nënparagrafit "a" (i), të paragrafit 9, të nenit 2 të Protokollit:

"Duhet të bëhen përshtatje/rregullime të potencialeve të ngrohjes globale të specifikuara në grupin I, të aneksit A, aneksit C dhe aneksit F dhe nëse po, cilat rregullime duhen bërë dhe".

Neni 2J

Neni i mëposhtëm shtohet pas nenit 2I të Protokollit, "Neni 2J: Hidrofluorkarbone"

1. Çdo palë duhet të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetëmujore, duke filluar nga data 1 janar 2019 dhe në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore pasuese, niveli i llogaritur i konsumit të substancave të kontrolluara sipas aneksit F i shprehur në ekuivalentet e CO_2, të mos kalojë përqindjen, e përcaktuar për intervalet përkatëse të viteve të specifikuara në nënparagrafët e mëposhtëm nga "a" në "e", të mesatares vjetore të niveleve të llogaritura të konsumit të substancave të kontrolluara të përcaktuara në aneksin F për vitet 2011, 2012 dhe 2013 plus pesëmbëdhjetë për qind të nivelit të llogaritur të konsumit të aneksit C, grupi I i substancave të kontrolluara, siç përcaktohet në paragrafin 1, të nenit 2F, shprehur në ekuivalentët e CO_2:

a) 2019 deri më 2023: 90 për qind;

b) 2024 deri më 2028: 60 për qind;

c) 2029 deri më 2033: 30 për qind;

d) 2034 deri më 2035: 20 për qind;

e) 2036 në vazhdim: 15 për qind.

2. Pavarësisht paragrafit 1 të këtij neni, palët mund të vendosin që një palë duhet të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetëmujore, duke filluar nga data 1 janar 2019 dhe në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore pasuese, niveli i llogaritur i konsumit të substancave të kontrolluara sipas aneksit F i shprehur në ekuivalentet e CO_2, të mos kalojë përqindjen e përcaktuar për intervalet përkatëse të viteve të specifikuara në nënparagrafët e mëposhtëm nga "a" në "e" të mesatares vjetore të niveleve të llogaritura të konsumit të substancave të kontrolluara të përcaktuara në aneksin F për vitet 2011, 2012 dhe 2013, plus njëzet e pesë për qind të nivelit të llogaritur të konsumit të aneksit C, grupi 1 i substancave të kontrolluara, siç përcaktohet në paragrafin l të nenit 2F, shprehur në ekuivalentët e CO_2.

a) 2020 deri më 2024: 95 për qind;

b) 2025 deri më 2028: 65 për qind;

c) 2029 deri më 2033: 30 për qind;

d) 2034 deri më 2025: 20 për qind;

e) 2036 në vazhdim: 15 për qind.

3. Çdo palë duhet të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetëmujore, duke filluar nga data 1 janar 2019 dhe në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore pasuese, niveli i llogaritur i konsumit të substancave të kontrolluara sipas aneksit F i shprehur në ekuivalentët e CO_2, të mos kalojë përqindjen e përcaktuar për intervalet përkatëse të viteve të specifikuara në nenparagrafët e mëposhtëm nga "a" në "e" të mesatares vjetore të niveleve të llogaritura të konsumit të substancave të kontrolluara të përcaktuara në aneksin F për vitet 2011, 2012 dhe 2013 plus pesëmbëdhjetë për qind të nivelit të llogaritur të konsumit të aneksit C, grupi I i substancave të kontrolluara, siç përcaktohet në paragrafin 2, të

nenit 2F, shprehur në ekuivalentët e CO_2

a) 2019 deri më 2023: 90 për qind;

b) 2024 deri më 2028: 60 për qind;

c) 2029 deri më 2033: 30 për qind;

d) 2034 deri më 2035: 20 për qind;

e) 2036 në vazhdim: 15 për qind.

4. Pavarësisht paragrafit 1 të këtij neni, palët mund të vendosin që një palë duhet të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetëmujore duke filluar nga data 1 janar 2019 dhe në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore pasuese, niveli i llogaritur i konsumit të substancave të kontrolluara sipas aneksit F i shprehur në ekuivalentët e CO_2 të mos kalojë përqindjen e përcaktuar për intervalet përkatëse të viteve të specifikuara në nënparagrafët e mëposhtëm nga "a" në "e" të mesatares vjetore të niveleve të llogaritura të konsumit të substancave të kontrolluara të përcaktuara në aneksin F për vitet 2011, 2012 dhe 2013 plus njëzet e pesë për qind të nivelit të llogaritur të konsumit të aneksit C, grupi I i substancave të kontrolluara, siç përcaktohet në paragrafin 2, të nenit 2F, shprehur në ekuivalentët e CO_2.

a) 2020 deri më 2024: 95 për qind;

b) 2025 deri më 2028: 65 për qind;

c) 2029 deri më 2033: 30 për qind;

d) 2034 deri më 2035: 20 për qind;

e) 2036 në vazhdim: 15 për qind.

5. Paragrafët nga 1 në 4 të këtij neni zbatohen deri në masën që Palët vendosin të lejojnë që niveli i prodhimit ose konsumit i nevojshëm për të përmbushur tipologjinë e përdorimit të rënë dakord nga palët për të qenë Palë të përjashtuara.

6. Çdo Palë që prodhon substanca të aneksit C, grupit I ose aneksit F duhet të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetëmujore, duke filluar nga data 1 janar 2020 dhe në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore pasuese, emetimet e substancave të aneksit F, grupit II të gjeneruara në çdo objekt që prodhon substanca të aneksit C, grupit I ose aneksit F, substancat shkatërrohen në të njëjtën periudhë dymbëdhjetëmujore, në masën e mundësuar nga përdorimi i teknologjisë, të miratuar nga Palët.

7. Çdo Palë duhet të sigurojë që çdo shkatërrim i substancave të aneksit F, grupit II, ose aneksit F të gjeneruara nga objektet që prodhojnë substanca të aneksit C, grupit I ose aneksit F, duhet të realizohet vetëm me teknologjitë e miratuara nga Palët.

Neni 3

Hyrja e nenit 3 të Protokollit do të zëvendësohet me përmbajtjen e mëposhtme:

"1. Për qëllimet e nenit 2, 2A në 2J dhe 5, çdo Palë duhet që për çdo grup substancash të aneksit A, aneksit B, aneksit C, aneksit E ose aneksit F, të përcaktojë nivelet e saj të llogaritura:"

Për pikëpresjen e fundit të nënparagrafëve (a) (i) të aneksit 3 të Protokollit do të zëvendësohet si më poshtë:

"Përjashtimisht, siç është parashikuar në paragrafin 2;"

Teksti i mëposhtëm shtohet në fund të nenit 3 të Protokollit:

"dhe

d) Emetimet e substancave të aneksit F, grupit II, të gjeneruara në çdo objekt që prodhon substanca të aneksit C, grupit I ose aneksit F, duke përfshirë ndër të tjera, sasitë e emetuara nga rrjedhjet e makinerive, proceseve të ventilimit dhe pajisjeve shkatërruese, por duke përjashtuar sasitë e kapura për përdorim, shkatërrim apo magazinim.

2. Për llogaritjen e niveleve të shprehura në ekuivalentë CO_2 të prodhimit, konsumit, importit, eksportit dhe emetimet e substancave të aneksit F dhe aneksit C, grupit I, për qëllimet e nenit 2J, paragrafi 5 i nenit 2 dhe paragrafit 1 (d) të nenit 3, çdo Palë duhet të përdorë potencialet e ngrohjes globale për substancat e specifikuara në grupin I të aneksit A, aneksit C dhe aneksit F".

Neni 4, paragrafi 1 sept

Paragrafi i mëposhtëm shtohet pas paragrafit 1 *sex* të nenit 4 të Protokollit:"

"*1 sept.* Me hyrjen në fuqi të këtij paragrafi, çdo Palë duhet të ndalojë importimin e substancave të kontrolluara të aneksit F nga çdo shtet që nuk është Palë e këtij Protokolli."

Neni 4, paragrafi 2 sept

Paragrafi i mëposhtëm shtohet pas paragrafit 2 *sex* të nenit 4 të Protokollit:

"2 sept. Me hyrjen në fuqi të këtij paragrafi, çdo Palë duhet të ndalojë eksportimin e substancave të kontrolluara të aneksit F, me çdo shtet jo Palë të këtij Protokolli."

Neni 4, paragrafët 5, 6 dhe 7

Në paragrafët 5, 6 dhe 7 të nenit 4 të Protokollit, fjalët:

"Aneksi A, B, C dhe E"

Ndryshohen si vijon:

"Aneksi A, B, C, E dhe F"

Neni 4, paragrafi 8

Në paragrafin 8, të nenit 4, të Protokollit, fjalët:

"Nenet 2A deri në 2I"

Ndryshohen me:

"Nenet "2A deri në 2J"

Neni 4B

Paragrafi i mëposhtëm shtohet pas paragrafit 2, të nenit 4B, të Protokollit:

"2 bis. Çdo Palë duhet, që duke filluar nga data 1 janar 2019 ose brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij paragrafi nëse është e mëvonshme, duhet të krijojë dhe zbatojë një sistem licencimi për importin dhe eksportin e substancave të kontrolluara të aneksit F, pavarësisht nëse janë të reja, të përdorura, të ricikluara dhe të rigjeneruara. Çdo Palë që vepron sipas paragrafit 1, të nenit 5 dhe që çmon se nuk është në gjendje të vendosë dhe zbatojë këtë sistem nga data 1 janar 2019, mund të vonojë ndërmarrjen e këtyre veprimeve deri më 1 janar 2021".

Neni 5

Në paragrafin 4, të nenit 5, të Protokollit, fjalët:

"2I"

Ndryshohen me:

"2J"

Në paragrafët 5 dhe 6, të nenit 5, të Protokollit, fjalët:

"Neni 2I"

Ndryshohen me:

"Neni 2I dhe 2J"

Në paragrafin 5, të nenit 5, të Protokollit, përpara fjalëve:

"çdo masë kontrolluese"

shtohet:

"me"

Paragrafi i mëposhtëm shtohet pas paragrafit 8 *ter*, të nenit 5, të Protokollit:

"8 qua

a) Çdo Palë që vepron sipas paragrafit 1 të këtij neni, në bazë të ndonjë rregullimi mbi masat e kontrollit në nenin 2J në përputhje me paragrafin 9, të nenit 2, ka të drejtë të vonojë pajtueshmërinë me masat e kontrollit, të paracaktuara në nënparagrafët nga "a" në "e", të paragrafit 1, të nenit 2J dhe nënparagrafëve nga "a" në "e", të paragrafit 3, të nenit 2J dhe të ndryshojë këto masa si më poshtë vijon:

i. 2024 deri më 2028: 100 për qind;
ii. 2029 deri më 2034: 90 për qind;
iii. 2035 deri më 2039: 70 për qind;
iv. 2040 deri më 2044: 50 për qind;
v. 2045 dhe në vazhdim: 20 për qind.

b) Pavarësisht nënparagrafit "a" të mësipërm, Palët mund të vendosin se një Palë e cila vepron sipas paragrafit l të këtij neni, në bazë të ndonjë rregullimi mbi masat e kontrollit në nenin 2J, në përputhje me paragrafin 9 të nenit 2, ka të drejtë të vonojë pajtueshmërinë e tij me masat e kontrollit të parapërcaktuara nga nënparagrafët nga "a" në "e", të paragrafit l, të nenit 2J dhe nënparagrafëve nga "a" në "e", të paragrafit 3, të nenit 2J, dhe të ndryshojë këto masa si më poshtë vijon:

i. 2028 deri më 2031: 100 për qind
ii. 2032 deri më 2036: 90 për qind
iii. 2037 deri më 2041: 80 për qind
iv. 2042 deri më 2046: 70 për qind
v. 2047 dhe në vazhdim: 15 për qind.

c) Çdo Palë që vepron sipas paragrafit l të këtij neni, për qëllime të llogaritjes së konsumit bazë sipas nenit 2J, i lind e drejta e përdorimit të mesatares së niveleve të llogaritura të konsumit të substancave të kontrolluara të aneksit F, për vitet 2020, 2021 dhe 2022, plus gjashtëdhjetë e pesë për qind të konsumit të tij bazë të substancave të kontrolluara të aneksit C, grupi I të përcaktuara në paragrafin 8 *ter* të këtij neni.

d) Pavarësisht nënparagrafit "c" të mësipërm, Palët mund të vendosin që një Palë e cila vepron sipas paragrafit 1, të këtij neni, për qëllime të Llogaritjes së nivelit bazë të konsumit sipas nenit 2J, i lind e drejta e përdorimit të mesatares së niveleve të llogaritura të konsumit të substancave të kontrolluara të aneksit F, për vitet 2024, 2025, 2025, plus gjashtëdhjetë e pesë për qind të konsumit të tij bazë për substancat e kontrolluara të aneksit C, grupit l, siç përcaktohet në paragrafin 8 *ter* të këtij neni.

e) Çdo Palë që vepron sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe që prodhon substancat e kontrolluara të aneksit F, për qëllime të llogaritjes së nivelit bazë të prodhimit sipas nenit 2J, i lind e drejta e përdorimit të mesatares së llogaritura të prodhimit të substancave të kontrolluara të aneksit F, për vitet 2020, 2021 dhe 2022, plus gjashtëdhjetë e pesë për qind të prodhimit bazë të aneksit C, grupit I, të substancave të kontrolluara siç përcaktohet në paragrafin 8 *ter* të këtij neni.

f) Pavarësisht nënparagrafit "e" të mësipërm, Palët mund të vendosin që një Palë e cila vepron sipas paragrafit 1, të këtij neni, dhe që prodhon substancat e kontrolluara të aneksit F, për qëllime llogaritëse të prodhimit bazë sipas nenit 2J, i lind e drejta e përdorimit të mesatares së llogaritur të prodhimit të substancave të kontrolluara të aneksit F për vitet 2024, 2025 dhe 2026, plus gjashtëdhjetë e pesë për qind të prodhimit bazë të substancave të kontrolluara të aneksit C, grupit I, siç përcaktohet në paragrafin 8 *ter* të këtij neni.

g) Nënparagrafët nga "a" në "f" të këtij paragrafi do të zbatohen për nivelet e llogaritura të prodhimit dhe konsumit, përveç rasteve kur zbatohet një përjashtim i vendosur nga palët në lidhje me temperatura të larta ambientale".

Neni 6

Neni 6 i Protokollit, fjalët:

"Nenet 2A deri 2I"

ndryshon:

"Nenet 2A deri 2J"

Neni 7, paragrafët 2, 3 dhe 3 ter

Rreshti vijues shtohet pas rreshtit me tekstin "- Në aneksin E, për vitin 1991," në paragrafin 2 të nenit 7, të Protokollit:

"- Në aneksin F, për vitet nga 2011 më 2013, përjashtimisht Palët që veprojnë sipas paragrafit 1, të nenit 5, duhet të sigurojnë këto të dhëna për vitet nga 2020 më 2022, por palët që veprojnë sipas paragrafit 1, të nenit 5, për të cilin zbatohen nënparagrafët "d" dhe "f", të paragrafit 8 *qua*, të nenit 5, duhet të sigurojnë të dhëna për vitet nga viti 2024 më 2026;"

Në paragrafët 2 dhe 3, të nenit 7, të Protokollit, fjalët:

"C dhe E"

Ndryshohen: "C, E dhe F"

Paragrafi i mëposhtëm shtohet në nenin 7 të Protokollit, pas paragrafit 3 bis:

"3 *ter*. Çdo Palë duhet t'i dërgojë Sekretariatit të dhëna statistikore për emetimet vjetore të substancave të kontrolluara për çdo objekt sipas aneksit F, grupit II, në përputhje me paragrafët 1(d) të nenit 3 të Protokollit."

Neni 7, paragrafi 4

Në paragrafin 4, të nenit 7, pas fjalëve:

"të dhëna statistikore mbi" dhe "siguron të dhëna të"

Shtohet:

"prodhim"

Neni 10, paragrafi 1

Në paragrafin 1, të nenit 10, të Protokollit, fjalët:

"dhe nenit 2I"

Ndryshohet:

"Neni 2I dhe neni 2J"

Përmbajtja e mëposhtme shtohet në fund të paragrafit 1, të nenit 10, të Protokollit:

"Kur një Palë që vepron sipas paragrafit 1, të nenit 5, zgjedh të përdorë fonde nga çdo mekanizëm tjetër financiar që mund të rezultojë në përmbushjen e ndonjë pjese të kostove shtesë të rëna dakord, ajo pjesë nuk do të plotësohet nga mekanizmi financiar, i parashikuar sipas nenit 10 të këtij Protokolli."

Neni 17

Në nenin 17, të Protokollit, fjalët:

"Nenet 2A deri në 2I"

Ndryshohen:

"Nenet 2A deri në 2J"

Aneksi A

Tabela me përmbajtje si më poshtë propozohet të zëvendësohet me tabelat për grupin I të shtojcës A të Protokollit:

Grupi	Substanca	Potenciali ozonhollues	Potenciali 100-Vjeçar i Ngrohjes Globale
Grupi I			
$CFCl_3$	(CFC-11)	1.0	4.750
CF_2Cl_2	(CFC-12)	1.0	10.900
$C_2F_3Cl_3$	(CFC-113)	0.8	6.130
$C_2F_4Cl_2$	(CFC-114)	1.0	10.000
C_2F_5Cl	(CFC-115)	0.6	7.370

Shtojca C dhe shtojca F

Tabela me përmbajtjen e mëposhtme propozohet të zëvendësojë tabelën për grupin 1 të shtojcës C të Protokollit:

Grupi	Substanca	Numri i izomereve	Potenciali ozonhollues	Potenciali 100-vjeçar i Ngrohjes Globale
Grupi 1				
$CHFCl_2$	(HCFC-21)**	1	0.04	151
CHF_2Cl	(HCFC-22)**	1	0.055	1810
CH_2FCl	(HCFC-3l)	1	0.02	
C_2HFCl_4	(HCFC-121)	2	0.01-0.04	
$C_2HF_2Cl_3$	(HCFC-122)	3	0.02-0.08	
$C_2HF_3Cl_2$	(HCFC-123)	3	0.02-0.06	77
$CHCl_2CF_3$	(HCFC-123)**	-	0.02	
C_2HF_4Cl	(HCFC-124)	2	0.02-0.04	609
$CHFClCF_3$	(HCFC-124)**	-	0.022	
$C_2H_2FCl_3$	(HCFC-131)	3	0.007-00.05	
$C_2H_2F_2Cl_2$	(HCFC-132)	4	0.008-0.05	
$C_2H_2F_3Cl$	(HCFC-133)	3	0.02-0.06	
$C_2H_3FCl_2$	(HCFC-141)	3	0.005-0.07	
CH_3CFCl_2	(HCFC-141b)**	_	0.11	725
$C_2H_3F_2Cl$	(HCFC-142)	3	0.008-0.07	
CH_3CF_2Cl	(HCFC-142b)**	-	0.065	2310
C_2H_4FCl	(HCFC-151)	2	0.003-0.005	
C_3HFCl_6	(HCFC-221)	5	0.015-0.07	
$C_3HF_2Cl_5$	(HCFC-222)	9	0.01-0.09	
$C_3HF_3Cl_4$	(HCFC-223)	12	0.01-0.08	
$C_3HF_4Cl_3$	(HCFC-224)	12	0.01-0.09	
$C_3HF_5Cl_2$	(HCFC-225)	9	0.02-0.07	
$CF_3CF_2CHCl_2$	(HCFC-225ca)**	-	0.025	122
CF_2ClCF_2CHClF	(HCFC-225cb)**	-	0.033	595
C_3HF_6Cl	(HCFC-226)	5	0.02-0.10	
$C_3H_2FCl_5$	(HCFC-231)	9	0.05-0.09	
$C_3H_2F_2Cl_4$	(HCFC-232)	16	0.008-0.10	
$C_3H_2F_3Cl_3$	(HCFC-233)	18	0.007-0.23	
$C_3H_2F_4Cl_2$	(HCFC-234)	16	0.01-0.28	
$C_3H_2F_5Cl$	(HCFC-235)	9	0.03-0.52	

$C_3H_3FCl_4$	(HCFC-241)	12	0.004-0.09	
$C_3H_3F_2Cl_3$	(HCFC-242)	18	0.005-0.13	
$C_3H_3F_3Cl_2$	(HCFC-243)	18	0.007-0.12	
$C_3H_3F_4Cl$	(HCFC-244)	12	0.009-0.14	
$C_3H_4FCl_3$	(HCFC-251)	12	0.001-0.01	
$C_3H_4F_2Cl_2$	(HCFC-252)	16	0.005-0.04	
$C_3H_4F_3Cl$	(HCFC-253)	12	0.003-0.03	
$C_3H_5FCl_2$	(HCFC-261)	9	0.002-0.02	
$C_3H_5F_2Cl$	(HCFC-262)	9	0.002-0.02	
C_3H_6FCl	(HCFC-271)	5	0.001-0.03	

* Kur vlerësohet një rang potencialesh ozonholluese, vlera më e lartë propozohet të përdoret për qëllime të Protokollit. Vlerat e potencialeve ozonholluese të renditura si vlera të vetme, janë përcaktuar nga llogaritjet bazuar në matje laboratorike. Ato që janë renditur si një rang vlerash janë përcaktuar bazuar në vlera të përafërta dhe janë më pak të qarta. Vargu i vlerave lidhet me grupin izometrik. Vlera më e lartë është vlerësimi me ndikim më të lartë të izomerit ozonhollues dhe vlera më e ulët është vlerësimi me ndikim më të ulët ozonhollues.

** Identifikon substancat me vlerë më të lartë të zbatueshme të potencialeve ozonholluese, të renditura kundrejt atyre të përdorura për qëllimet e Protokollit.

*** Për substancat për të cilat nuk ka asnjë të dhënë për Potencialin e Ngrohjes Globale, zbatohet vlera 0 derisa një vlerë e Potencialit të Ngrohjes Globale të përfshihet nëpërmjet procedurave të parashikuara në paragrafin 9 (a) (ii), të nenit 2.

Shtojca me përmbajtje si më poshtë, propozohet të shtohet në Protokoll pas shtojcës E.

"Shtojca F: Substancat e kontrolluara

Grupi	Substanca	Potenciali 100-Vjeçar i Ngrohjes Globale
Grupi I		
CHF_2CHF_2	HFC-134	1100
CH_2FCF_3	HFC-134a	1430
CH_2FCHF_2	HFC-143	353
$CHF_2CH_2CF_3$	HFC-245fa	1030
$CF_3CH_2CF_2CH_3$	HFC-365mfc	794
CF_3CHFCF_3	HFC-227ea	3220
$CH_2FCF_2CF_3$	HFC-236cb	1340
CHF_2CHFCF_3	HFC-236ea	1370
$CF_3CH_2CF_3$	HFC-236fa	9810
$CH_2FCF_2CHF_2$	HFC-245ca	693
$CF_3CHFCHFCF_2CF_3$	HFC-43-10mee	1640
CH_2F_2	HFC-32	675
CHF_2CF_3	HFC-125	3500
CH_3CF_3	HFC-143a	4470
CH_3F	HFC-41	92
CH_2FCH_2F	HFC-152	53
CH_3CHF_2	HFC-152a	124
Grupi II		
CHF_3	HFC-23	14800

Neni II: Lidhja me Amendamentin e vitit 1999

Asnjë shtet ose organizatë me integritet ekonomik rajonal nuk mund të depozitojë një dokument për ratifikim, pranim, miratim ose zgjerim të këtij Amendamenti vetëm në rast se është depozituar më parë, ose njëkohësisht një dokument i tille në Amendamentin e miratuar në Takimin e Njëmbëdhjetë të Palëve në Pekin, më 3 dhjetor 1999.

Neni III: Lidhja me Kuadrin e Konventës së Kombeve të Bashkuara dhe Protokollit përkatës të Kiotos mbi Ndryshimet Klimatike

Ky Amendament nuk synon të ketë efektin e përjashtimit të hidrofluorkarboneve nga fusha e angazhimeve në përmbajtje të neneve 4 dhe 13, të Kuadrit të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike ose të neneve 2, 5, 7 dhe 10, të Protokollit të Kiotos.

Neni IV: Hyrja në fuqi

1. Pritet, siç është përcaktuar në paragrafin 2, të mëposhtëm, që ky Amendament të hyjë në fuqi më 1 janar 2019, duke siguruar që të paktën njëzet instrumente ratifikimi, pranimi ose miratimi të Amendamentit të jenë depozituar nga shtetet apo organizatat me integritet ekonomik rajonal, Palë të Protokollit të Montrealit mbi Substancat që Hollojnë Shtresën e Ozonit. Në rastin e mosplotësimit të kushtit deri në datën e caktuar, Amendamenti propozohet të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë vijuese të datës kur është përmbushur.

2. Ndryshimet e bëra në nenin 4, të Protokollit, Kontrolli i tregtimit me vendet jopalë, të përcaktuar në nenin I, të këtij Amendamenti, propozohet të hyjë në fuqi më 1 janar 2033, duke siguruar që të paktën shtatëdhjetë instrumente ratifikimi, pranimi apo miratimi të Amendamentit, të jenë depozituar nga shtetet apo organizatat me integritet ekonomik rajonal, të cilat janë Palë e Protokollit të Montrealit mbi Substancat që Hollojnë Shtresën e Ozonit. Në rastin e mosplotësimit të këtij kushti deri në datën e caktuar, Amendamenti propozohet të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë vijuese të datës kur është përmbushur.

3. Për qëllimet e paragrafëve 1 dhe 2, çdo instrument i depozituar nga organizatat me integritet ekonomik rajonal nuk do të merret parasysh si shtesë e atyre të depozituara nga shtetet pjesë të këtyre organizatave.

4. Pas hyrjes në fuqi të Amendamentit, siç parashikohet në paragrafët 1 dhe 2, propozohet të miratohet për secilën Palë tjetër të Protokollit në ditën e nëntëdhjetë vijuese të datës së depozitimit të instrumentit përkatës të ratifikimit, pranimit apo miratimit.

Neni V: Zbatimi i përkohshëm

Secila Palë, në çdo kohë përpara se të miratojë këtë Amendament, mund të deklarojë se do të zbatojë përkohësisht masat kontrolluese të përcaktuara në nenin 2J dhe detyrimet përkatëse raportuese të nenit 7, në pritje të hyrjes në fuqi të këtij Amendamenti.

LIGJ
Nr. 100/2018

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 7764, DATË 2.11.1993, "PËR INVESTIMET E HUAJA", TËNDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 11/1, pika 1, fjalët "31 dhjetor 2018 " zëvendësohen me fjalët "31 dhjetor 2019".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 13.12.2018

Shpallur me dekretin nr. 11004, datë 18.12.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

LIGJ
Nr. 101/2018

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 93/2015, "PËR TURIZMIN", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, bëhen shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 6, paragrafi numërtohet me numrin 1 dhe pas tij shtohen pikat 2 e 3 me këtë përmbajtje:

"2. Përjashtohet nga mbështetja dhe lehtësitë e parashikuara në kreun VI, të këtij ligji, çdo investitor/operator menaxhues, çdo person që është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i tij, aksionar ose ortak i investitorit / operatorit menaxhues, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse apo kontrolluese brenda tij, që është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;

b) korrupsion;

c) mashtrim;

ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;

dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit e shitjes së narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;

e) falsifikim;

ë) shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

3. Për përfitimin e mbështetjes dhe të lehtësive të parashikuara në kreun VI, të këtij ligji, subjektet e përcaktuara në pikën 2 duhet të paraqesin një vërtetim të gjendjes gjyqësore ose një dokument të lëshuar nga një autoritet kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni.".

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 13.12.2018

Shpallur me dekretin nr. 11005, datë 18.12.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

LIGJ
Nr. 102/2018

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 55/2015 "PËR INVESTIMET STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 55/2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë" bëhen shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 13 bëhen këto shtesa:

a) Në pikën 1, pas shkronjës "e" shtohet shkronja "ë" me këtë përmbajtje:

"ë) vërtetim mbi gjendjen gjyqësore ose një dokument, të lëshuar nga një autoritet kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikën 1/1, të këtij neni.".

b) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1. Subjekti përjashtohet nga përfitimi i statusit "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar", apo "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë", nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e veprës penale:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;

b) korrupsion;

c) mashtrim;

ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;

dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;

e) falsifikim;

ë) shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

Përjashtimi nga shqyrtimi, miratimi dhe mbështetja e investimeve strategjike zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i një subjekti investues, aksionar ose ortak i tij, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij.”.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 13.12.2018

Shpallur me dekretin nr. 11006, datë 18.12.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

LIGJ
Nr. 103/2018

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9643, DATË 20.11.2006, “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 45 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Autoriteti kontraktor skualifikon nga procedura e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike çdo operator ekonomik, nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;

b) korrupsion;

c) mashtrim;

ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;

dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;

e) falsifikim;

ë) shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

Detyrimi për të skualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operator ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.”.

2. Paragrafi i parë i pikës 3 ndryshohet si më poshtë:

“Me qëllim plotësimin e kushteve të parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

a) vërtetim mbi gjendjen gjyqësore ose një dokument, të lëshuar nga një autoritet kompetent, që vërteton kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, shkronjat “a”, “b” dhe “c”.”

3. Kudo ku përmenden, në titull dhe në përmbajtjen e këtij neni, fjalët “kandidatë ose ofertues” zëvendësohen me fjalët “operator ekonomik”.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 13.12.2018

Shpallur me dekretin nr. 11007, datë 18.12.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

LIGJ
Nr. 104/2018

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR. 9374, DATË 21.4.2005, "PËR NDIHMËN SHTETËRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, bëhet shtesa si më poshtë:

Neni 1

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 4/1
Përjashtimi nga përfitimi i ndihmës shtetërore

1. Subjekti përjashtohet nga përfitimi i ndihmës shtetërore nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e veprës penale:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;

b) korrupsion;

c) mashtrim;

ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;

dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;

e) falsifikim;

ë) shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

2. Përjashtimi nga përfitimi i ndihmës shtetërore zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i subjektit përfitues të ndihmës, në kuptim të këtij ligji, aksionar ose ortak i tij, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

3. Me qëllim plotësimin e kushteve për të përfituar ndihmën shtetërore, subjekti përfitues i ndihmës duhet të paraqesë vërtetim mbi gjendjen gjyqësore, ose një dokument të lëshuar nga një autoritet kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni.".

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 13.12.2018

Shpallur me dekretin nr. 11008, datë 18.12.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

AKT NORMATIV
Nr. 2, datë 19.12.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.109/2017, "PËR BUXHETIN E VITIT 2018", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni l

Nenet 1, 2, 3, 4 dhe 8 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"Neni 1

Buxheti për vitin 2018 është:

Të ardhurat	461 865	milionë lekë;
Shpenzimet	494 231	milionë lekë;
Deficiti	32 366	milionë lekë.

Ai përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale: sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i pronarëve.

Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2018 është:

Të ardhurat	348 717	milionë lekë;
Shpenzimet	381 083	milionë lekë;
Deficiti	32 366	milionë lekë.

Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2018 është:

Të ardhurat	49 620	milionë lekë;

Nga të cilat:

- transferta e pakushtëzuar nga buxheti qendror	16 600	milionë lekë;
- transferta specifike	7 454	milionë lekë;
- të ardhura të tjera	25 566	milionë lekë;
Shpenzimet	49 620	milionë lekë.

Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2018 është:

l. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror:

Të ardhurat, gjithsej	121 551	milionë lekë;

Nga të cilat:

- kontributet	77 160	milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	39 646	milionë lekë;
- transferta nga buxheti për indeksimin e pensioneve	1 445	milionë lekë;
- transferta për bonusin e pensionistëve	3 300	milionë lekë;
Shpenzimet	121 551	milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe të kategorive të veçanta të personave të vetëpunësuar, duke mbuluar nga buxheti i shtetit diferencën midis këtyre kontributeve me masën e kontributit të përcaktuar për personat e vetëpunësuar në qytet. Për vitin 2018, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve të sigurimit shoqëror dhe programeve të tjera të veçanta e suplementare, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Skema e sigurimit suplementar:

Të ardhurat, gjithsej	5 809	milionë lekë;

Nga të cilat:

- kontributet	1 376	milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	4 333	milionë lekë;
- fondi për indeksimin e pensioneve	100	milionë lekë;
Shpenzimet	5 809	milionë lekë.

Fondi për indeksimin e pensioneve është 1 545 milionë lekë. Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2 550 milionë lekë dhe janë të ndara sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.

Neni 8

Të ardhurat e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Grantet	12 000	milionë lekë;
Të ardhurat tatimore	310 959	milionë lekë;
Të ardhurat jotatimore	25 757	milionë lekë".

Neni 2

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Shpenzime të buxhetit qendror	375 583	milionë lekë;
Fondi rezervë	1 500	milionë lekë;
Kontingjencë për risqet e borxhit	4 000	milionë lekë.”.

b) Tabelat 1 dhe 4, të përmendura në nenin 10, zëvendësohen me tabelat me të njëjtin numërtim, që i bashkëlidhen këtij akti normativ dhe janë pjesë përbërëse të tij. Shtesa e grantit prej 300 milionë lekësh në programin e arsimit të lartë përdoret për përmirësimin e kushteve në konviktet e studentëve të Bashkisë Tiranë.

Neni 3

Neni 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 13

Fondi rezervë i buxhetit prej 1 500 milionë lekësh përdoret nga Këshilli i Ministrave, për raste të paparashikuara të institucioneve buxhetore.

Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4 000 milionë lekësh përdoret për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.”.

Neni 4

Tabela 3, që përmendet në nenin 16, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numërtim, që i bashkëlidhet këtij akti normativ dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 5

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

AKTI NORMATIV nr. 2 2018 - BUXHETI 2018 SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

Kodi	Emërtimi i institucionit / programit	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale	
1	**Presidenca**	**225,800**	**18,000**	**0**	**18,000**	**243,800**
01120	Veprimtaria e Presidentit	225,800	18,000	0	18,000	243,800
2	**Kuvendi**	**934,200**	**102,000**	**25,000**	**127,000**	**1,061,200**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	334,400	102,000	25,000	127,000	461,400
01120	Veprimtaria ligjvënëse	599,800	0	0	0	599,800
3	**Kryeministria**	**446,200**	**165,000**	**526,904**	**691,904**	**1,138,104**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	446,200	165,000	526,904	691,904	1,138,104
5	**Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**	**5,087,268**	**1,660,975**	**2,520,336**	**4,181,311**	**9,268,579**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	291,928	5,000	0	5,000	296,928
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,535,600	309,975	232,650	542,625	2,078,225
04240	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	736,430	827,000	976,122	1,803,122	2,539,552
04250	Zhvillimi Rural duke mbësht. prodh. bujq, blek, agroind dhe market.	2,130,560	423,460	1,159,584	1,583,044	3,713,604
04860	Këshillimi dhe informacioni bujqësor	211,250	8,998	0	8,998	220,248
05470	Menaxhimi qëndrueshëm i tokës bujqësore	16,000	0	0	0	16,000
04230	Mbështetje për peshkimin	99,200	61,542	71,150	132,692	231,892
05640	Administrimi i ujërave	66,300	25,000	80,830	105,830	172,130
6	**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**	**5,697,830**	**22,753,550**	**19,229,800**	**41,983,350**	**47,681,180**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	830,700	40,787	0	40,787	871,487
04520	Transporti rrugor	1,911,960	15,401,041	6,338,100	21,739,141	23,651,101
04540	Transporti detar	103,260	59,800	220,000	279,800	383,060
04550	Transporti hekurudhor	423,680	50,000	0	50,000	473,680
04560	Transporti ajror	15,610	5,000	0	5,000	20,610
06370	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	1,062,780	3,448,287	5,251,219	8,699,506	9,762,286
06220	Menaxhimi i mbetjeve urbane	753,000	1,564,272	250,000	1,814,272	2,567,272
04320	Mbështetje për energjinë	90,900	1,660,394	6,823,481	8,483,875	8,574,775
04430	Mbështetje për burimet natyrore	154,500	218,297	0	218,297	372,797
04440	Mbështetje për industrinë	253,740	146,172	0	146,172	399,912
06180	Planifikimi urban	97,700	159,500	347,000	506,500	604,200
10	**Ministria e Financave dhe Ekonomisë**	**50,149,915**	**2,681,059**	**1,276,460**	**3,957,519**	**54,107,434**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	794,245	411,183	462,982	874,165	1,668,410
01120	Menaxhimi i shpenzimeve publike	510,500	10,000	0	10,000	520,500
01130	Ekzekutimi i pagesave të ndryshme	330,000	368,000	0	368,000	698,000
01140	Menaxhimi i të ardhurave tatimore	2,343,267	282,000	5,000	287,000	2,630,267
01150	Menaxhimi i të ardhurave doganore	3,202,155	269,348	186,991	456,339	3,658,494
01160	Lufta kundër transaksioneve financiare joligjore	70,800	18,336	0	18,336	89,136
04130	Mbështetje për zhvillim ekonomik	236,000	84,800	207,000	291,800	527,800
04160	Mbështetje për mbikëq. e tregut, infrast. e eilës. dhe pron. industr.	254,000	19,500	5,000	24,500	278,500
10220	Sigurimi shoqëror	39,004,000	0	0	0	39,004,000
10550	Tregu i punës	1,222,008	76,031	0	76,031	1,298,039
04170	Inspektimi në punë	173,540	10,000	0	10,000	183,540
09240	Arsimi i mesëm (profesional)	1,680,600	932,661	409,487	1,342,148	3,022,748
06190	Strehimi	328,800	199,200	0	199,200	528,000

Kodi	Emërtimi i institucionit / programit	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale	
11	**Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë**	**34,807,312**	**3,219,343**	**280,000**	**3,499,343**	**38,306,655**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	685,042	55,682	0	55,682	740,724
09120	Arsimi baze (përfshirë parashkollorin)	20,322,580	1,694,947	0	1,694,947	22,017,527
09230	Arsimi i mesëm (i përgjithshëm)	6,072,617	876,191	0	876,191	6,948,808
09450	Arsimi universitar	6,996,273	325,000	250,000	575,000	7,571,273
09770	Fonde për shkencën	318,300	32,122	30,000	62,122	380,422
08140	Zhvillimi i sportit dhe rinisë	412,500	235,401	0	235,401	647,901
12	**Ministria e Kulturës**	**1,367,532**	**853,000**	**0**	**853,000**	**2,220,532**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	152,276	0	0	0	152,276
08220	Trashëgimia kulturore dhe muzetë	450,207	193,000	0	193,000	643,207
08230	Arti dhe kultura	765,049	660,000	0	660,000	1,425,049
13	**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtës Sociale**	**55,668,729**	**1,580,327**	**1,849,400**	**3,429,727**	**59,098,456**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	536,940	8,946	0	8,946	545,886
07220	Shërbimet e kujdesit parësor	8,368,220	356,429	438,600	795,029	9,163,249
07330	Shërbimet e kujdesit dytësor	20,929,362	880,471	1,380,800	2,261,271	23,190,633
07450	Shërbimet e shëndetit publik	2,805,377	0	0	0	2,805,377
07460	Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	254,300	221,531	0	221,531	475,831
10430	Përkujdesi Social	21,724,930	112,950	30,000	142,950	21,867,880
10460	Përfshirja sociale	16,800	0	0	0	16,800
01190	Rehabilitimi i tëpërndjekurve politikë	1,032,800	0	0	0	1,032,800
14	**Ministria e Drejtësisë**	**9,550,200**	**582,015**	**256,000**	**838,015**	**10,388,215**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	475,400	117,823	201,000	318,823	794,223
01120	Publikimet zyrtare	44,500	15,000	0	15,000	59,500
01130	Mjekësia ligjore	79,000	7,400	0	7,400	86,400
03440	Sistemi i burgjeve	5,360,600	400,000	55,000	455,000	5,815,600
03350	Shërbimi i përmbarimit gjyqësor	149,000	9,000	0	9,000	158,000
01160	Shërbimet për çështjet e birësimeve	8,900	250	0	250	9,150
01180	Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	3,302,100	25,542	0	25,542	3,327,642
03490	Shërbimi i provës	130,700	7,000	0	7,000	137,700
15	**Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**	**2,476,780**	**153,000**	**190,000**	**343,000**	**2,819,780**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	108,500	102,000	0	102,000	210,500
01120	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	2,072,550	10,000	0	10,000	2,082,550
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ-së	192,400	0	0	0	192,400
01150	Mbështetja institucionale për procesin e integrimit	103,330	41,000	190,000	231,000	334,330
16	**Ministria e Brendshme**	**18,433,052**	**1,469,304**	**767,900**	**2,237,204**	**20,670,256**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	1,074,759	41,000	0	41,000	1,115,759
03140	Policia e Shtetit	14,662,184	1,264,176	747,543	2,011,719	16,673,903
03150	Garda e Republikës	1,502,769	159,000	0	159,000	1,661,769
01160	Prefekturat dhe funksionet e deleguara të pushtetit vendor	527,240	5,128	20,357	25,485	552,725
01170	Shërbimi i gjendjes civile	666,100	0	0	0	666,100
17	**Ministria e Mbrojtjes**	**17,225,948**	**2,023,162**	**0**	**2,023,162**	**19,249,110**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	1,208,141	28,000	0	28,000	1,236,141
02120	Forcat e luftimit	4,702,032	1,837,162	0	1,837,162	6,539,194
09430	Arsimi ushtarak	552,750	0	0	0	552,750
02150	Mbështetja e luftimit	4,625,390	63,000	0	63,000	4,688,390
07340	Mbështetje për shëndetësinë	876,069	0	0	0	876,069
10270	Mbështetje sociale për ushtarakët	4,974,600	0	0	0	4,974,600
10910	Emergjencat civile	286,966	95,000	0	95,000	381,966
18	**Shërbimi Informativ Shtetëror**	**1,426,100**	**50,000**	**0**	**50,000**	**1,476,100**
03520	Veprimtaria informative shtetërore	1,426,100	50,000	0	50,000	1,476,100
19	**Drejtoria e Radio Televizionit**	**565,000**	**100,000**	**0**	**100,000**	**665,000**
08310	Shërbimet për shqiptarët jashtë kufirit	240,000	0	0	0	240,000
08520	Projekte teknike për futjen e teknologjive të reja	200,000	100,000	0	100,000	300,000
08330	Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarëkombëtare	65,000	0	0	0	65,000
08340	Orkestra simfonike e RTSH-së dhe Kinematografisë	60,000	0	0	0	60,000
20	**Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave**	**165,500**	**42,900**	**0**	**42,900**	**208,400**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	165,500	42,900	0	42,900	208,400
22	**Akademia e Shkencës**	**99,950**	**800**	**0**	**800**	**100,750**
01520	Veprimtaria akademike	99,950	800	0	800	100,750
24	**Kontrolli Lartë i Shtetit**	**374,900**	**26,600**	**30,000**	**56,600**	**431,500**
01120	Veprimtaria audituese e KLSH-së	374,900	26,600	30,000	56,600	431,500
26	**Ministria e Turizmit dhe Mjedisit**	**1,225,674**	**346,403**	**592,200**	**938,603**	**2,164,277**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	156,260	1,306	0	1,306	157,566
05320	Programe për mbrojtjen e mjedisit	476,807	176,406	310,000	486,406	963,213
04260	Administrimi i pyjeve	452,100	54,893	282,200	337,093	789,193
04760	Zhvillimi i turizmit	140,507	113,798	0	113,798	254,305
28	**Prokuroria e Përgjithshme**	**1,510,900**	**91,935**	**0**	**91,935**	**1,602,835**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	1,510,900	91,935	0	91,935	1,602,835
29	**Zyra e Administrimit Buxhetit Gjyqësor**	**1,984,000**	**160,700**	**0**	**160,700**	**2,144,700**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	29,000	700	0	700	29,700
03310	Buxheti gjyqësor	1,955,000	160,000	0	160,000	2,115,000
30	**Gjykata Kushtetuese**	**109,500**	**4,000**	**0**	**4,000**	**113,500**
03320	Veprimtaria gjyqësore kushtetuese	109,500	4,000	0	4,000	113,500
31	**Agjencia Telegrafike Shqiptare**	**70,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**71,000**
08320	Veprimtaria telegrafike e ATSH-se	70,000	1,000	0	1,000	71,000
40	**Partitë politike**	**200,000**	**0**	**0**	**0**	**200,000**
01110	Mbështetje për partitë politike	190,000	0	0	0	190,000
01120	Mbështetje për shoqatat	8,000			0	8,000
01130	Mbështetje për organizatat e veteraneve me status	2,000			0	2,000
50	**Instituti Statistikës**	**501,900**	**28,000**	**60,000**	**88,000**	**589,900**
01320	Veprimtaria statistikore	501,900	28,000	60,000	88,000	589,900
55	**Shkolla e Magjistraturës**	**120,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**121,000**
09820	Veprimtaria arsimore	120,000	1,000	0	1,000	121,000
56	**Fondi i Zhvillimit Shqiptar**	**0**	**13,866,000**	**2,803,000**	**16,669,000**	**16,669,000**
06210	Programe zhvillimi	0	6,166,000	2,803,000	8,969,000	8,969,000
06220	Infrastruktura vendore dhe rajonale	0	7,700,000	0	7,700,000	7,700,000
57	**Qendra Kombëtare e Kinematografisë**	**162,300**	**2,000**	**0**	**2,000**	**164,300**
08220	Mbështetja e veprimtarisë kinematografike	162,300	2,000	0	2,000	164,300

Kodi	Emërtimi i institucionit / programit	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale	
63	**Institucione të mbikëqyrjes dhe rivlerësimit të sistemit të drejtësisë**	**362,900**	**26,000**	**0**	**26,000**	**388,900**
03320	Veprimtaria mbikëqyrëse e KLD-së	72,000	2,000	0	2,000	74,000
03330	Veprimtaria e rivlerësimit kalimtar të magjistratit	149,200	8,000	0	8,000	157,200
03340	Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar	99,000	10,200	0	10,200	109,200
03360	Veprimtaria e komisionerit publik	42,700	5,800	0	5,800	48,500
66	**Avokati i Popullit**	**105,000**	**4,000**	**0**	**4,000**	**109,000**
03320	Shërbimi i avokatisë	105,000	4,000	0	4,000	109,000
67	**Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil**	**53,620**	**4,000**	**0**	**4,000**	**57,620**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	53,620	4,000	0	4,000	57,620
73	**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**	**125,300**	**3,000**	**0**	**3,000**	**128,300**
01610	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	125,300	3,000	0	3,000	128,300
01620	Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	0	0		0	0
76	**Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave**	**133,200**	**3,000**	**0**	**3,000**	**136,200**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	133,200	3,000		3,000	136,200
77	**Autoriteti i Konkurrencës**	**71,800**	**8,000**	**0**	**8,000**	**79,800**
04120	Mbikëqyrja e tregut dhe garantimi i konkurrencës	71,800	8,000	0	8,000	79,800
82	**Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit**	**8,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**9,500**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	8,500	1,000	0	1,000	9,500
87	**Institucione të tjera qeveritare**	**3,318,939**	**882,927**	**160,000**	**1,042,927**	**4,361,866**
01320	Shërbime qeveritare	200,000	30,943	0	30,943	230,943
01130	Shërbimi i Prokurimit Publik	75,150	6,000	0	6,000	81,150
01120	Agjencia për diasporën dhe migracionin	14,000	6,000	0	6,000	20,000
01150	Shërbime të tjera	421,750	56,722	0	56,722	478,472
01140	e-Qeverisja	2,185,162	715,417	50,000	765,417	2,950,579
01330	Menaxhimi dhe zhvillimi i administratës publike	294,477	67,845	110,000	177,845	472,322
08480	Mbështetje për kultet fetare	128,400	0	0	0	128,400
88	**Mbështetje për shoqërinë civile**	**122,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**123,500**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	122,500	1,000	0	1,000	123,500
89	**Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**	**65,100**	**4,000**	**0**	**4,000**	**69,100**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	65,100	4,000	0	4,000	69,100
90	**Veprimtaria e komisionit të prokurimit publik**	**36,100**	**1,000**	**0**	**1,000**	**37,100**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	36,100	1,000	0	1,000	37,100
91	**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**	**35,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**36,000**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	35,000	1,000	0	1,000	36,000
92	**Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit**	**32,700**	**1,000**	**0**	**1,000**	**33,700**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	32,700	1,000	0	1,000	33,700
95	**Autoriteti për të Drejtën e Informimit**	**45,000**	**12,000**	**0**	**12,000**	**57,000**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	45,000	12,000	0	12,000	57,000

Tab.3

Transferta e pakushtëzuar dhe specifike për bashkitë për vitin 2018

Në mijë lekë

NR.	Bashkitë	Transferta e pakushtëzuar 2018	Shtesë nga Kuvendi, "Transfertë e pakushtëzuar 2018"	Transfertat specifike për financimin e funksioneve									Totali
				Konviktet e arsimit parauniversitar	Arsimi parashkollor	Arsimi parauniversitar	Mbrojtja nga zjarri	Mbrojtja sociale	Administrimi i pyjeve	Rrugët	Ujitja dhe Kullimi	Fond për investime për ujitjen dhe kullimin	
1	Bashkia Belsh	114,003		0	22,855	1,199	12,944	0	700	7,751	9,589		169,041
2	Bashkia Berat	277,104		27,103	132,005	13,579	30,550	23,496	4,575	4,776	14,250		527,439
3	Bashkia Bulqizë	250,827		0	53,607	0	14,005	0	7,777	28,283	12,850	28,000	395,348
4	Bashkia Cërrik	134,965		4,550	41,691	4,557	13,107	0	1,019	1,780	13,550		215,219
5	Bashkia Delvinë	62,731		0	23,274	1,739	13,067	0	2,053	3,339	9,589		115,792
6	Bashkia Devoll	179,417		0	51,776	2,423	13,292	0	3,648	10,282	10,990		271,827
7	Bashkia Dibër	389,259		23,831	132,076	9,261	21,500	0	6,688	13,863	13,550		610,029
8	Bashkia Divjakë	193,958	10,000	0	43,455	1,268	12,393	0	700	7,677	28,594		298,045
9	Bashkia Dropull	77,039		0	2,308	1,102	12,944	0	3,605	4,970	5,970		107,937
10	Bashkia Durrës	782,972		22,510	184,761	18,240	48,405	0	2,587	23,695	43,047		1,126,217
11	Bashkia Elbasan	636,618		28,164	244,541	32,192	30,890	20,899	9,861	17,248	14,250		1,034,663
12	Bashkia Fier	550,044		21,062	194,005	10,679	33,084	0	3,265	8,410	56,238		876,788
13	Bashkia Finiq	110,442	10,000	0	7,439	0	12,393	0	2,881	2,770	14,951		160,877
14	Bashkia Fushë Arrëz	74,411		0	30,512	4,484	13,107	0	9,563	13,255	2,709		148,042
15	Bashkia Gjirokastër	197,092		17,891	96,746	5,869	28,584	0	5,698	7,563	9,230		368,672
16	Bashkia Gramsh	203,496	20,000	6,391	71,747	3,604	13,851	0	9,410	19,176	9,589		357,263
17	Bashkia Has	132,483		6,662	27,936	2,857	14,706	0	7,212	1,573	9,589		203,018
18	Bashkia Himarë	113,915		0	12,089	602	12,508	0	6,390	4,404	9,589		159,497
19	Bashkia Kamzë	478,714		0	114,578	9,748	12,393	0	0	0	3,409		618,843
20	Bashkia Kavajë	201,634	5,000	12,595	80,728	6,390	16,543	0	700	5,530	18,912		348,031
21	Bashkia Këlcyrë	57,955		0	8,585	2,767	13,107	0	2,566	7,563	9,589		102,132
22	Bashkia Klos	131,262		0	27,749	1,752	12,944	0	5,722	9,929	2,709		192,067
23	Bashkia Kolonjë	114,153		9,621	33,017	3,971	13,216	0	9,924	8,807	10,289		202,998
24	Bashkia Konispol	56,303		0	8,320	0	12,944	0	1,395	1,705	10,289		90,957
25	Bashkia Korçë	419,527		21,665	171,524	18,289	29,092	0	12,294	6,457	43,178		722,026
26	Bashkia Krujë	265,083		0	78,032	3,527	15,018	0	4,850	7,016	15,651		389,178
27	Bashkia Kuçovë	152,991		0	70,759	6,762	14,185	2,596	1,181	1,986	12,850		263,310
28	Bashkia Kukës	298,908		19,244	99,821	4,791	45,583	2,473	8,520	18,958	5,970		504,267
29	Bashkia Kurbin	217,207		0	79,921	14,838	13,576	0	2,289	3,819	19,612		351,262
30	Bashkia Lezhë	301,030		9,208	106,649	10,307	28,991	0	6,404	5,107	21,714		489,408
31	Bashkia Libohovë	39,260		0	5,252	1,112	12,944	0	2,198	6,267	2,709		69,742
32	Bashkia Librazhd	258,865	10,000	0	70,409	3,065	13,851	0	7,134	23,766	12,850		399,939
33	Bashkia Lushnje	382,365	10,000	9,158	152,393	11,051	14,569	0	1,401	7,232	44,579		632,747
34	Bashkia Malësi e Madhe	272,293		4,166	45,700	5,115	13,764	0	10,650	12,741	11,690		376,119
35	Bashkia Maliq	278,456		0	71,308	10,018	12,944	0	4,688	8,559	37,816		423,791
36	Bashkia Mallakastër	154,194		0	69,486	6,576	14,512	0	2,319	7,068	12,850		267,004
37	Bashkia Mat	178,112		12,479	66,558	5,769	14,005	0	6,580	24,809	9,589		317,901
38	Bashkia Memaliaj	99,342		0	33,232	7,246	12,944	0	2,658	4,322	2,709		162,452
39	Bashkia Mirditë	190,761		21,665	57,746	7,356	15,708	0	10,966	18,478	12,850		335,529
40	Bashkia Patos	112,464	10,000	0	50,357	3,470	14,512	0	0	1,781	10,289		202,872
41	Bashkia Peqin	121,003		0	36,598	3,788	13,574	0	1,162	4,246	9,589		189,960
42	Bashkia Përmet	112,464	5,000	6,499	24,776	4,618	13,454	0	4,720	6,699	9,589		187,820

43	Bashkia Pogradec	337,545		0	116,964	9,270	13,672	0	5,687	20,102	10,289		513,529
44	Bashkia Poliçan	93,447	20,000	0	28,958	3,953	13,450	0	2,852	3,366	2,709		168,735
45	Bashkia Përrenjas	161,381		0	33,736	2,875	13,107	0	4,711	18,112	9,589		243,512
46	Bashkia Pukë	107,891		13,540	38,672	6,702	14,465	0	9,368	6,345	2,709		199,692
47	Bashkia Pustec	32,536		0	5,382	0	8,861	0	700	306	2,709		50,494
48	Bashkia Roskovec	102,436		0	22,326	2,275	12,944	0	0	3,889	6,670		150,540
49	Bashkia Rrogozhinë	134,879		0	28,405	2,313	12,393	0	1,143	0	9,589		188,722
50	Bashkia Sarandë	121,224		18,189	52,916	3,543	17,736	0	2,101	0	5,970		221,679
51	Bashkia Selenicë	160,626		0	25,429	7,675	12,944	0	3,698	2,699	12,850		225,921
52	Bashkia Shijak	128,808		0	38,690	2,923	12,393	0	700	47	5,970		189,531
53	Bashkia Shkodër	606,231		57,315	161,805	24,189	34,441	19,371	9,226	18,396	26,734		957,708
54	Bashkia Skrapar	116,888		10,970	43,308	6,342	13,571	0	3,513	12,418	9,589		216,599
55	Bashkia Tepelenë	77,599		6,662	37,330	3,445	13,454	0	4,115	6,050	2,709		151,365
56	Bashkia Tiranë	2,138,631		89,012	660,440	85,553	109,163	0	8,049	19,433	20,430		3,130,711
57	Bashkia Tropojë	195,853		0	47,369	3,490	14,705	0	10,638	8,560	2,709		283,324
58	Bashkia Ura Vajgurore	124,063		0	30,760	1,576	13,067	0	700	3,699	17,870		191,736
59	Bashkia Vau i Dejës	201,808		8,634	36,329	2,293	12,393	19,000	5,394	5,605	11,690		303,146
60	Bashkia Vlorë	503,332		25,513	248,093	31,053	34,350	0	4,875	2,669	37,763		887,650
61	Bashkia Vorë	110,735		0	34,516	4,923	12,393	0	700	480	9,589		173,336
Fond për investime							50,000						50,000
TOTALI		**14,831,033**	**100,000**	**514,298**	**4,627,747**	**470,375**	**1,185,209**	**87,835**	**276,130**	**515,834**	**847,538**	**28,000**	**23,484,000**

Tab.4

TREGUESIT FISKALË TË BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2015–2020
Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2015–2020

në milionë lekë (in million lek)

Nr.	EMËRTIMI	Faktik 2015	Në % të PBB	Faktik 2016	Në % të PBB	Faktik 2017	Në % të PBB	Akti normativ nr. 2 2018	Në % të PBB	Buxheti 2019	Ne % të PBB	Buxheti 2020	Në % të PBB	ITEMS
	TOTALI I TË ARDHURAVE	**379,206**	**26.6%**	**407,021**	**27.6%**	**430,492**	**27.7%**	**461,864**	**28.0%**	**486,677**	**27.8%**	**518,716**	**27.8%**	**TOTAL REVENUE**
I.	**Të ardhura nga ndihmat**	**11,215**	**0.8%**	**14,639**	**1.0%**	**11,085**	**0.7%**	**12,000**	**0.7%**	**15,500**	**0.9%**	**15,500**	**0.8%**	**Grants**
	Nga të cilat: mbështetje buxhetore		*0.0%*	*0*	*0.0%*	*2,738*	*0.2%*	*2,500*	*0.2%*	*2,500*	*0.1%*	*2,500*	*0.1%*	*from which: Budget Support*
II.	**Të ardhura tatimore**	**342,308**	**24.0%**	**369,884**	**25.1%**	**398,629**	**25.7%**	**424,107**	**25.7%**	**447,337**	**25.5%**	**478,911**	**25.6%**	**Tax Revenue**
II.1	**Nga Tatimet dhe Doganat**	**258,882**	**18.1%**	**275,780**	**18.7%**	**293,386**	**18.9%**	**310,959**	**18.9%**	**325,604**	**18.6%**	**349,369**	**18.7%**	**From tax offices and customs**
	Tatimi mbi vlerën e shtuar	125,783	8.8%	131,390	8.9%	139,541	9.0%	146,553	8.9%	153,314	8.7%	164,908	8.8%	V.A.T
	Tatimi mbi fitimin	24,968	1.7%	29,151	2.0%	31,645	2.0%	33,823	2.1%	33,500	1.9%	35,976	1.9%	Profit Tax
	Akcizat	39,027	2.7%	41,896	2.8%	45,105	2.9%	48,443	2.9%	48,300	2.8%	51,716	2.8%	Excise Tax
	Tatimi mbi të ardhurat personale	29,661	2.1%	31,412	2.1%	32,102	2.1%	36,800	2.2%	41,900	2.4%	44,818	2.4%	Personal Income Tax
	Taksa Nacionale dhe të tjera	33,647	2.4%	35,794	2.4%	38,502	2.5%	38,340	2.3%	41,200	2.4%	44,070	2.4%	National Taxes and others
	Taksa doganore	5,796	0.4%	6,137	0.4%	6,492	0.4%	7,000	0.4%	7,390	0.4%	7,881	0.4%	Customs Duties
II.2	**Të ardhura nga pushteti vendor**	**11,700**	**0.8%**	**14,951**	**1.0%**	**18,447**	**1.2%**	**20,586**	**1.2%**	**22,661**	**1.3%**	**24,167**	**1.3%**	**Local Taxes**
	Taksa lokale	5,746	0.4%	9,675	0.7%	13,273	0.9%	14,845	0.9%	15,106	0.9%	16,110	0.9%	Local Taxes
	Tatimi mbi pasurinë (ndërtesat)	3,921	0.3%	4,678	0.3%	4,879	0.3%	5,339	0.3%	6,915	0.4%	7,374	0.4%	Property Tax
	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël	2,033	0.1%	598	0.0%	296	0.0%	402	0.0%	640	0.0%	683	0.0%	Simple profit tax of small bisness
II.3	**Të ardhurat nga fondet speciale**	**71,726**	**5.0%**	**79,153**	**5.4%**	**86,796**	**5.6%**	**92,562**	**5.6%**	**99,071**	**5.7%**	**105,375**	**5.6%**	**Revenues from Special Funds**
	Sigurimi shoqëror	60,148	4.2%	66,688	4.5%	74,000	4.8%	78,536	4.8%	84,342	4.8%	89,733	4.8%	Social Insurance
	Sigurimi shëndetësor	9,595	0.7%	10,820	0.7%	11,602	0.7%	12,526	0.8%	13,729	0.8%	14,642	0.8%	Health insurance
	Të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve	1,983	0.1%	1,645	0.1%	1,194	0.1%	1,500	0.1%	1,000	0.1%	1,000	0.1%	Revenues for owners' in value-compensation
III.	**Të ardhura jotatimore**	**25,683**	**1.8%**	**22,498**	**1.5%**	**20,778**	**1.3%**	**25,757**	**1.6%**	**23,840**	**1.4%**	**24,305**	**1.3%**	**Nontax Revenue**
	Tran. fitimi nga Banka e Shqipërisë	951	0.1%	1,095	0.1%	908	0.1%	1,000	0.1%	1,000	0.1%	1,000	0.1%	Profit transfer from BOA
	Të ardhura nga institucionet buxhetore	17,183	1.2%	15,001	1.0%	13,789	0.9%	15,977	1.0%	13,830	0.8%	14,000	0.7%	Income of budgetary institutions
	Dividenti	528	0.0%	83	0.0%	178	0.0%	800	0.0%	820	0.0%	845	0.0%	Divident
	Tarifat e Shërbimeve	2,519	0.2%	2,738	0.2%	2,332	0.2%	3,400	0.2%	3,480	0.2%	3,500	0.2%	Services Fees
	Të tjera	4,502	0.3%	3,581	0.2%	3,570	0.2%	4,580	0.3%	4,710	0.3%	4,960	0.3%	Others
	TOTALI I SHPENZIMEVE	**437,408**	**30.6%**	**433,697**	**29.4%**	**461,410**	**29.7%**	**494,231**	**30.0%**	**519,577**	**29.6%**	**548,559**	**29.3%**	**TOTAL EXPENDITURE**
I.	**Shpenzime korrente**	**350,752**	**24.6%**	**368,720**	**25.0%**	**382,287**	**24.6%**	**408,530**	**24.8%**	**426,069**	**24.3%**	**450,496**	**24.1%**	**Current Expenditures**
1	**Personeli**	**72,489**	**5.1%**	**67,540**	**4.6%**	**72,642**	**4.7%**	**75,935**	**4.6%**	**80,753**	**4.6%**	**82,973**	**4.4%**	**Personnel expenditures**
	Paga	62,492	4.4%	58,215	4.0%	61,471	4.0%	63,516	3.9%	65,643	3.7%	68,209	3.6%	Wages
	Kontributi për sigurime shoqërore	9,997	0.7%	9,325	0.6%	10,061	0.6%	10,819	0.7%	11,110	0.6%	11,764	0.6%	Social insurance contributions
	Fondi i veçantë i pagave							400	0.0%	500	0.0%	500	0.0%	Bonus fund
	Politika të reja pagash							0	0.0%	2,000	0.1%	1,000	0.1%	Contingency for new wage policies
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta					1,110	0.1%	1,200	0.1%	1,500	0.1%	1,500	0.1%	Higher Education from its own revenues
2	**Interesat**	**38,643**	**2.7%**	**36,259**	**2.5%**	**31,904**	**2.1%**	**41,000**	**2.5%**	**41,700**	**2.4%**	**47,538**	**2.5%**	**Interest**
	Të brendshme	27,385	1.9%	25,526	1.7%	21,415	1.4%	23,300	1.4%	24,500	1.4%	28,238	1.5%	Domestic
	Të huaja	11,258	0.8%	10,733	0.7%	10,489	0.7%	13,700	0.8%	12,900	0.7%	12,300	0.7%	Foreign
	Kontingjencë për risqet e borxhit						0.0%	4,000	0.2%	4,300	0.2%	7,000	0.4%	Contingency for debt related risks
3	**Shpenzime operative mirëmbajtje nga të cilat:**	**42,409**	**3.0%**	**44,329**	**3.0%**	**43,441**	**2.8%**	**46,184**	**2.8%**	**46,852**	**2.7%**	**48,941**	**2.6%**	**Operational & Maintenance of which:**
	Të qeverisjes qendrore				*0.0%*			*42,384*	*2.6%*	*42,852*	*2.4%*	*44,641*	*2.4%*	*Central government*
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta				*0.0%*			*1,800*	*0.1%*	*1,900*	*0.1%*	*2,000*	*0.1%*	*from revenues of Higher Education System*
	Të tjera jashtë limitit				*0.0%*			*2,000*	*0.1%*	*2,100*	*0.1%*	*2,300*	*0.1%*	*from Exceptional Revenues*
4	**Subvencionet**	**1,735**	**0.1%**	**1,725**	**0.1%**	**2,310**	**0.1%**	**1,881**	**0.1%**	**1,490**	**0.1%**	**1,490**	**0.1%**	**Subsidies**

5	**Shpenzime për fondet speciale**	**141,166**	**9.9%**	**152,591**	**10.4%**	**162,146**	**10.4%**	**171,760**	**10.4%**	**179,987**	**10.3%**	**191,185**	**10.2%**	**Social insurance outlays**
	Sigurime shoqërore	107,309	7.5%	114,276	7.8%	119,081	7.7%	122,515	7.4%	130,637	7.5%	138,965	7.4%	Social insurance
	Politika të reja pensionesh				0.0%			1,545	0.1%	2,450	0.1%	2,520	0.1%	Contingency for new pension policies
	Fond shpërblimi për pensionistet							3,300	0.2%					
	Sigurime shëndetësore	32,695	2.3%	34,796	2.4%	39,090	2.5%	40,400	2.5%	41,900	2.4%	44,200	2.4%	Health insurance
	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	1,162	0.1%	3,519	0.2%	3,974	0.3%	4,000	0.2%	5,000	0.3%	5,500	0.3%	Expenditure for owners' in value-compensation
6	**Shpenzime për buxhetin vendor**	**34,066**	**2.4%**	**43,580**	**3.0%**	**46,487**	**3.0%**	**49,620**	**3.0%**	**51,286**	**2.9%**	**53,869**	**2.9%**	**Local Budget expenditure**
	Granti nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor	22,366	1.6%	28,629	0.0%			24,054	1.5%	25,075	1.4%	26,032	1.4%	Central Government Grant for Local Government
	Fond i pakushtëzuar							*16,600*	*1.0%*	*17,632*	*1.0%*	*18,600*	*1.0%*	*Unconditional Fund*
	Grant specifik							*7,454*	*0.5%*	*7,443*	*0.4%*	*7,432*	*0.4%*	*Specific Grant*
	Te ardhura nga taksat dhe tarifat vendore	11,700	0.8%	14,951	1.0%			20,586	1.2%	22,661	1.3%	24,167	1.3%	Local Budget (Own revenues)
	Buxheti vendor (të ardhura nga taksat e ndara)		0.0%		0.0%			600	0.0%	650	0.0%	670	0.0%	Local Budget (from shared taxes revenues)
	Buxheti vendor (nga të ardhurat jotatimore)		0.0%		0.0%			3,100	0.2%	2,900	0.2%	3,000	0.2%	Local Budget (from non-tax revenues)
	Financimi i huaj vendor							1,280	0.1%					
7	**Shpenzime të tjera**	**20,244**	**1.4%**	**22,696**	**1.5%**	**23,357**	**1.5%**	**22,150**	**1.3%**	**24,000**	**1.4%**	**24,500**	**1.3%**	**Other expenditures**
	Pagesa e papunësisë	615	0.0%	691	0.0%	346	0.0%	350	0.0%	500	0.0%	600	0.0%	Unemployment insurance benefits
	Ndihma ekonomike dhe paaftësia	17,662	1.2%	20,026	1.4%	20,714	1.3%	20,500	1.2%	20,500	1.2%	20,900	1.1%	Social assistance and disability
	Shpërblimi i familjeve në nevojë							300	0.0%	1,000				
	Kompensim për ish-të përndjekurit politikë	1,967	0.1%	1,979	0.1%	2,298	0.1%	1,000	0.1%		0.0%	1,000	0.1%	Compensation for ex political prisoners
	Bonusi i lindjeve									2,000	0.1%	2,000	0.1%	
II.	**Fondi rezervë**	**0**	**0.0%**	**0**	**0.0%**	**0**	**0.0%**	**1,500**	**0.1%**	**2,900**	**0.2%**	**4,000**	**0.2%**	**Reserve fund, Contingency**
	Fondi rezervë				0.0%		0.0%	1,500	0.1%	1,500	0.1%	1,500	0.1%	Reserve Fund
	Rezerve për reformën në Drejtësi				0.0%		0.0%		0.0%	1,400	0.1%	2,500	0.1%	Contingency for deficit financing
III.	**Shpenzime kapitale**	**63,059**	**4.4%**	**59,478**	**4.0%**	**68,456**	**4.4%**	**84,201**	**5.1%**	**90,608**	**5.2%**	**94,063**	**5.0%**	**Capital expenditures**
	Financimi i brendshëm	38,133	2.7%	39,118	2.7%	45,589	2.9%	52,934	3.2%	56,908	3.2%	57,945	3.1%	Domestic financing
	Nga e cila: Fondi për infrastrukturën vendore dhe rajonale						*0.0%*	*7,700*	*0.5%*		*0.0%*			*from which: Local and Regional Infrastructure Fund*
	Investime nga të ardhurat e arsimit të lartë					588	0.0%	700	*0.0%*	1,100	0.1%	1,200	*0.1%*	From Higher Education System's own revenues
	Financimi i huaj	24,926	1.7%	20,360	1.4%	22,278	1.4%	30,567	1.9%	32,600	1.9%	34,918	1.9%	Foreign financing
	nga të cilat: Energjia							*6,200*	*0.4%*	*3,000*	*0.2%*	*3,000*	0.2%	*from which: Energy*
IV	**Detyrimet e prapambetura**	**17,597**	**1.2%**											**Arrears Payment**
	Detyrimet e infrastrukturës	6,111	0.4%											Infrastructure Arrears
	Detyrimet tatimore	5,666	0.4%											Tax Arrears
	FSDKSH	5,820	0.4%											Health insurance arrears
V	**Huadhënie neto për energjinë**	**1,000**	**0.1%**	**5,499**	0.4%	**9,217**	0.6%	**0**	0.0%	**0**	0.0%	**0**	0.0%	**Net Lending for Energy Support**
	Hua e dhënë për energjinë	1,000	0.1%				0.0%		0.0%	0	0.0%	0	0.0%	Borrowing to Energy Sector
	Hua e kthyer nga sistemi energjetik						0.0%							Repayment from Energy Sector
VI	**Fond shpronësimi**	**5,000**	**0.4%**			**1,450**	0.1%							
	DEFIÇITI	**-58,202**	**-4.1%**	**-26,676**	**-1.8%**	**-30,919**	**-2.0%**	**-32,366**	**-2.0%**	**-32,900**	**-1.9%**	**-29,843**	**-1.6%**	**Cash Balance**
	FINANCIMI DEFIÇITIT	**58,202**	**4.1%**	**26,676**	**1.8%**	**30,919**	**2.0%**	**32,366**	**2.0%**	**32,900**	**1.9%**	**29,843**	**1.6%**	**Financing (Cash)**
	I brendshëm	**-6,403**	**-0.4%**	**9,176**	**0.6%**	**1,805**	**0.1%**	**-230**	**0.0%**	**48,597**	**2.8%**	**13,177**	**0.7%**	**Domestic**
	Të ardhura nga privatizimi	877	0.1%	2,805	0.2%	418	0.0%	50						Privatization receipts
	Huamarrje e brendshme	-17,268	-1.2%	10,602	0.7%	16,285	1.0%	19,947	1.2%	22,900	1.3%	22,900	1.2%	Domestic borrowing
	Të tjera	9,988	0.7%	-4,231		-14,898		-20,227	-1.2%	25,697	1.5%	-9,723	-0.5%	
	I huaj	**64,605**	**4.5%**	**17,500**	**1.2%**	**29,113**	**1.9%**	**32,596**	**2.0%**	**-15,697**	**-0.9%**	**16,666**	**0.9%**	**Foreign**
	Hua afatgjatë (e marrë)	17,832	1.2%	18,780	1.3%	23,407	1.5%	83,596	5.1%	19,700	1.1%	84,918	4.5%	Long-term Loan(Drawings)
	Ndryshimi i gjendjes së arkës	-2,992	-0.2%	-408	0.0%	169	0.0%							
	Ripagesat	-61,693	-4.3%	-21,998	-1.5%	-25,769	-1.7%	-52,000	-3.2%	-35,397	-2.0%	-68,252	-3.7%	Repayments
	Mbështetje buxhetore	111,458	7.8%	21,126	1.4%	31,306	2.0%	1,000	0.1%					Budget support
	Produkti i Brendshëm Bruto (PBB)	***1,427,799***	***100%***	***1,472,791***	***100%***	***1,552,868***	***100%***	***1,647,625***	***100%***	***1,752,736***	***100%***	***1,869,208***	***100%***	***Gross Domestic Product (GDP)***

NJOFTIM
Nr. 19082, datë 18.12.2018

MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi, për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi), për qarkullim ndërkombëtar rrugor dhe liqenor pasagjerësh", nënshkruar më 3.7.2018, hyrë në fuqi më 12 dhjetor 2018.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Gazmend Barbullushi

NJOFTIM
Nr. 19087, datë 18.12.2018

MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE DYPALËSHE ME GJERMANINË

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin "Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale", nënshkruar më 24 shtator 2018, ka hyrë në fuqi në datën 23 nëntor 2018.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Gazmend Barbullushi

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë